



Instituti
për
politikë
evroplane.
Shkup



Институт за демократија
Социетас цивилис - Скопје

CEA
Center for Economic Analyses

VLERËSIMI I NDIKIMIT TË LEGJISLACIONIT MBI LIGJIN PËR GJYKATA

Dhjetor 2018



Financuar nga
Bashkimi Evropian



VLERËSIMI

**I NDIKIMIT
TË LEGJISLACIONIT
MBI LIGJIN**

PËR GJYKATA

Vlerësimi i ndikimit të legjislacionit mbi Ligjin për gjykata

Botues:

Instituti për Politikë Evropiane - Shkup

Redaktore:

Dr. Simonida Kacarska

Autorë:

Mr. Iva Conevska

Mr. Ismail Kamberi

Përktheu (në shqip):

Blerina Starova Zllatku

Përpunimi grafik dhe shtypi:

Relativ

CIP - Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

347.9(497.7)(094.5)(047.31)

CONEVSKA, Iva

Vlerësimi i ndikimit të legjislacionit mbi Ligjin për gjykata / [autorë Iva Conevska, Ismail Kamberi]. - Shkup : Instituti për Politikë Evropiane, 2018. - 71 стр. : илустр. ; 25 см

ФУСНОТИ КОН ТЕКСТОТ

ISBN 978-608-4702-36-8

1. Kamberi, Ismail [автор]

а) Закон за судови - Процена на влијанието на регулативата - Македонија

- Истражувања

COBISS.MK-ID 109271050

Analiza është pjesë e programit për nëngrantim në kuadër të projektit Vlerësimi i Ndikimit të Legjislacionit në Hijë: Promovimi i krijimit të politikave të bazuara në prova. Projekti është financuar nga Bashkimi Evropian. Ky publikim u hartua me ndihmën e Bashkimit Evropian. Përmbajtja e publikimit është përgjegjësi ekskluzive e Institutit për Politikë Evropiane dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se i pasqyron pikëpamjet e Bashkimit Evropian, Institutit për Demokraci "SocietasCivilis" – Shkup (IDSCSH) dhe Qendrës për Analizë Ekonomike (QAE).

PËRMBAJTJA

Parathënie.....	5
Hyrja dhe metodologjia.....	6
1.Parimet themelore.....	9
1.1.Transparenca.....	10
1.2.Efikasiteti dhe gjykimi në afat të arsyeshëm.....	11
1.3.Pavarësia dhe paanshmëria e gjyqtarëve.....	13
2.Organizimi dhe kompetencat.....	15
2.1.Analiza e dokumenteve dhe standardeve ndërkombëtare.....	15
2.2.Gjendjet në Republikën e Maqedonisë në lidhje me strukturën e rrjetit të sistemit gjyqësor.....	17
2.3.Opsione në lidhje me strukturën e rrjetit të sistemit gjyqësor dhe ndikimi i tyre.....	26
2.3.1.Opsioni – Struktura e pandryshuar organizative e sistemit gjyqësor dhe kompetencave të gjykatave.....	26
2.3.2.Opsioni – Struktura e re organizative e sistemit gjyqësor dhe kompetencave të reja të gjykatav.....	28
3.Gjyqtarë dhe gjyqtarë-porotë.....	33
3.1.Analiza e standardeve dhe rekomandimeve ndërkombëtare.....	33
3.2.Gjendjet në Republikën e Maqedonisë në lidhje me gjyqtarët dhe gjyqtarët-porotë.....	35
3.3.Opsione në lidhje me përzgjedhjen dhe avancimin e gjyqtarëve dhe ndikimi i tyre.....	39
3.3.1.Opsioni – Zgjidhja ekzistuese në lidhje me zgjedhjen dhe avancimin e gjyqtarëve, sistematizimi nga njëri departament në tjetrin, si dhe transferimi i përkohshëm i gjyqtarëve në gjykatë tjetër.....	39
3.3.2.Opsioni – Ndryshimi i dispozitave të cilat kanë të bëjnë me zgjedhjen dhe avancimin e gjyqtarëve, sistematizimin nga njëri departament në tjetrin, si dhe transferimi i përkohshëm i gjyqtarëve në gjykatë tjetër.....	40
4.Ndërprerja dhe shkarkimi nga funksioni i gjyqtarit.....	45
4.1.Analiza e dokumentave, rekomandimeve dhe standardeve ndërkombëtare.....	45
4.2.Gjendjet në Republikën e Maqedonisë në lidhje me bazat e përgjegjesisë së gjyqtarëve.....	48
4.3.Opsione në lidhje me bazat e përcaktimit të përgjegjesisë të definuara në Ligjin për gjykata dhe ndikimi i tyre.....	49
4.3.1.Opsioni – Bazat e pandryshuara për përcaktimin e përgjegjesisë të definuara në Ligjin për gjykata.....	49
4.3.2.Opsioni – Ndryshimi i bazave për përcaktimin e përgjegjesisë të definuara në Ligjin për gjykata.....	50
5.Sistemi informatikë gjyqësor.....	53
5.1.Analiza e dokumenteve dhe standardeve ndërkombëtare.....	53
5.2.Gjendjet në RM në lidhje me sistemin e automatizuar për administrimin me lëndë gjyqësore (AKMIS).....	54
5.3.Opsione në lidhje me sistemin informatikë gjyqësor dhe ndikimi i tyre.....	55
5.3.1.Opsioni – gjendje e pandryshuar në lidhje me sistemin informatikë gjyqësor.....	55
5.3.2.Opsioni – avancimi dhe revizioni i sistemit informatikë gjyqësor.....	55
5.3.3.Opsioni - ndryshimi i Ligjit për gjykata në lidhje me trupin për administrim me sistemin informatikë gjyqësor dhe themelimi i Qendrës për Koordinim dhe Administrim me Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit në organet e jurisprudencës.....	56
6.Mjetet e punës.....	59
Pikëpamjet dhe rekomandimet përfundimtare.....	61
Literatura e përdorur.....	65
ANEKSI 1 – Të dhëna për gjykatat për vitet 2015, 2016 dhe 2017.....	70
ANEKSI 2 – Procesi i vlerësimit të ndikimit të legjislacionit në vendet e Ballkanit.....	72
Implementimi i VNL në Kroaci.....	73
Implementimi i VNL Bullgari.....	74
Implementimi i VNL në Serbi.....	76
Implementimi i VNL në Mal të Zi.....	77



PARATHËNIE

Kjo analizë ka për qëllim të kontribuoj në avancimin e gjendjeve dhe implementimin e standardeve evropiane në pjesën e gjyqësorit, duke e pasur parasysh kontekstin nacional.

E njëjta u përpilua nga Instituti për Politikë Evropiane – Shkup (EPI) në kuadër të projektit “Aplikimi i vlerësimit të ndikimit të legjislacionit (VNL) mbi Ligjin për gjykata”, ndërsa është mbështetur nga Instituti për Demokraci “Societas Civilis” – Shkup (IESCSH) në bashkëpunim me Qendrën për Analiza Ekonomike (QAE) në kuadër të projektit “Vlerësimi i ndikimit të legjislacionit në hije: Promovimi i krijimit të politikave të bazuara në prova”, financuar nga Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shkup.

Për hartimin e kësaj analize kontribuoi procesi inkluziv gjatë përgatitjes së ndryshimeve të Ligjit për gjykata dhe Ligjit për Këshillin Gjyqësor të RM, që e mundësoi Ministria e Drejtësisë, si dhe përfshirja e EPI në Grupin e Punës për përgatitjen e ndryshimeve. Ju shprehim falënderime të gjithë praktikantëve dhe ekspertëve të cilët morën pjesë në hulumtimin në terren dhe kontribuuan në përgatitjen dhe avancimin e cilësisë së analizës.

Shpresojmë se analiza do t'i shërbej Ministrisë së Drejtësisë dhe publikut profesionistë në procesin e përgatitjes dhe implementimit të reformave në gjyqësor.



HYRJE DHE METODOLOGJIA

Kjo analizë ka për qëllim ta bëjë vlerësimin e ndikimit të legjislacionit (VNL) mbi Ligjin për gjykata me përcaktimin e opsioneve më përkatëse për përmirësimin e gjendjeve në këtë fushë.

Republika e Maqedonisë filloi ta implementoj VNL nga janari i vitit 2009 dhe pas kësaj të gjitha ministrinë kanë obligim ta implementojnë VNL kur propozojnë ligje të reja¹. Qasja sistematike u sigurua përmes miratimit të **“Udhëzimit për mënyrën e veprimit gjatë punës së ministrive në procesin e implementimit të vlerësimit të ndikimit të legjislacionit”**². Me këtë Udhëzues përcaktohet mënyra e veprimit të punës së ministrive në procesin e zbatimit të vlerësimit të ndikimit të legjislacionit. Nga ana tjerët, Qeveria ka miratuar **“Metodologji për vlerësimin e ndikimit të legjislacionit”**³ndërsa në **“Rregulloren e punës të Qeverisë së RM”**⁴janë përcaktuar obligimet e ministrave për zbatim të detyrueshëm të VNL përveç në lëndët për të cilat kjo mundësi është përjashtuar për shkak të natyrës së tyre.

Për hartimin e kësaj analize u grumbulluan dhe analizuan të dhëna primare dhe sekondare **përmes metodave kuantitative dhe kualitative të hulumtimit.**

1 Vlerësimi i Ndikimit të Legjislacionit (VNL) – Fokusi mbi Maqedoninë (2009), Analitika. I aksesshëm në: <https://www.analyticamk.org/files/ReportNo32Mak.pdf>

2 “Gazeta Zyrtare e RM”, nr. 106/13.

3 “Gazeta Zyrtare e RM”, nr. 107/13.

4 “Gazeta Zyrtare e RM”, nr. 38/01, 98/02, 9/03, 47/03, 64/03, 67/03, 51/06, 5/07, 15/07, 26/07, 30/07, 58/07, 105/07, 116/07, 129/07, 157/07, 29/08, 51/08, 86/08, 114/08, 42/09, 62/09, 141/09, 162/09, 40/10, 83/10, 166/10, 172/10, 95/11, 151/11, 170/11, 67/13, 145/14, 62/15, 41/16 dhe 153/16.

Dizajni i hulumtimit u udhëhoq nga standardet ndërkombëtare, nga gjendjet në fushën dhe problemet me të cilat ballafaqohet gjyqësori, të cilat janë theksuar në raportet ndërkombëtare dhe në Strategjinë për reformë të sektorit të jurispru- dencës.⁵U shqyrtuan:

Raportet e progresit nga Komisioni Evropian nga viti 2009 përfundimisht me vitin 2018⁶

Raportet e Grupit të Ekspertëve të Rajnhard Pribe⁷ dhe të Prioriteve Urgjente të Reformave.⁸

Rekomandimet e Komisionit të Venecias.⁹

Rekomandimet e GREKO për Republikën e Maqedonisë.¹⁰

Masat e buta të Këshillit të Evropës.

Sa i përket strukturës organizative u shqyrtua edhe Raporti i Komisionit Evropian për efikasitetin e drejtësisë “Sistemi gjyqësor evropian, efikasiteti dhe kualiteti i drejtësisë” edicioni 2018 dhe “Udhëzuesi i reviduar për krijimin e hartave gjy- qësore”.

Përmes qasjes komparative u shqyrtuan bazat juridike për zbatimin e vlerësimit të ndikimit të legjislacionit në vendet e Ballkanit (më konkretisht në Kroaci, Bullgari, Serbi dhe në Mal të Zi). U implementua analiza normative e Ligjit për gjykata dhe ligjet relevante të fushës. U krijua edhe një pasqyrë e historikut të gjendjeve nga viti 1995 deri më sot në lidhje me organizimin dhe kompetencën e gjykatave.¹¹

5 Strategjia për reformë të sektorit të jurispru- dencës për periudhën kohore 2017 -2022 me Plan veprim, i aksesshëm në: <http://www.pravda.gov.mk/Upload/Documents/29.11.2017AkciskiPlannovo%20za%20veb.pdf>

6 Raportet e Komisionit Evropian janë të aksesshme në: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/countries/package_en

7 Raportet janë të aksesshme në: <https://goo.gl/9ebS9S>, <https://goo.gl/VFhANI>

8 Prioritetet Urgjente të Reformave janë të aksesshme në: https://eeas.europa.eu/sites/eeas/files/urgent_reform_priorities_en.pdf

9 U shqyrtuan më shumë opinione të Komisionit të Venecias: Komisioni i Venecias, opinioni për Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Këshillin Gjyqësor dhe Ligjit për ndryshime dhe plotësim të Ligjit për gjykata, 22 tetor 2018, të aksesshëm në: [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdf-file=CDL-AD\(2018\)022-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdf-file=CDL-AD(2018)022-e);

Opinionii i Komisionit të Venecias për ligjet për përgjegjësi disiplinore dhe notimin e gjyqtarëve, dhjetor 2015, i aksesshëm në: [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdf=CDL-AD\(2015\)042-ehttps://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdf=CDL-AD\(2015\)042-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdf=CDL-AD(2015)042-ehttps://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdf=CDL-AD(2015)042-e)

; Opinioni i Komisionit të Venecias për projekt ndryshimet e Ligjit për gjykata dhe për të drejtat dhe obligimet e gjyqtarëve dhe të Këshillit Gjyqësor të Malit të Zi, i aksesshëm në: [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdf=CDL-AD\(2014\)038-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdf=CDL-AD(2014)038-e)

Opinionii për Bosnje e Hercegovinën është i aksesshëm në linkun si vijon: [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL\(1999\)078-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL(1999)078-e)

Opinionii i Komisionit të Venecias për emërimin e gjyqtarëve, 2007, i aksesshëm në: [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdf=CDL-AD\(2007\)028-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdf=CDL-AD(2007)028-e)

10 Raport i GREKO, Rrethi i katërt i evaluimit Parandalimi i korrupsionit lidhur me deputetët, gjyqtarët dhe prokurorët, 22 qershor 2018, i aksesshëm në: <https://rm.coe.int/-80-18-22-/16808cc861>

11 Përfundimisht me ndryshimet e Ligjit për gjykata në maj të vitit 2018. në mënyrë Plotësuese u shqyrtuan dhe propozuan ndryshime të ligjit të cilët u publikuan në ENER më datë 09.11.2018.

Në mënyrë plotësuese, informacionet e nevojshme për hartimin e analizës u grumbulluan nga portali gjyqësor sud.mk dhe përmes adresimit të kërkesave për qasje të lirë deri te informacionet me karakter publik pranë Këshillit Gjyqësor të RM. Në analizë janë përfshirë dhe janë trajtuar të dhëna nga raportet vjetore të punës së gjykatave nga viti 2015 deri në vitin 2017, të pasqyruara në tabela dhe grafike, me qëllim të vlerësimit më të lehtë të gjendjeve. U përgatit një pasqyrë grafike, **në lidhje me numrin e gjyqtarëve në RM**, sipas viteve dhe konform Vendimit të Këshillit Gjyqësor për sistematizimin e vendeve të punës.

U realizua hulumtimi **në terren me të cilin u detektuan problemet në praktikë dhe u diskutua për opsionet e mundshme** dhe ndikimet e opsioneve.¹² Si bazë për hulumtimin paraprakisht u përgatit pyetësori, duke e marrë parasysh metodologjinë dhe manualin për vlerësimin e ndikimit të legjislacionit.¹³ Fokusi u vendos mbi organizimin dhe kompetencën e gjykatave, kushtet e zgjedhjes dhe avancimit të gjyqtarëve, specializimin e gjyqtarëve, sistematizimin nga njëri departament në tjetrin, si dhe transferimi i përkohshëm i gjyqtarëve në gjykatë tjetër, bazat e përgjegjësisë së gjyqtarëve dhe avancimi dhe revizioni i sistemit AKMIS. Hulumtimi në terren përbëhej nga katër fokus grupe me gjyqtarë, kryetarë të gjykatave, përfaqësues të komunitetit akademikë dhe sektori qytetar.¹⁴ Fokus grupet u krijuan për katër rajonet e apelit në Republikën e Maqedonisë. U realizuan 7 intervista me gjyqtarë, ekspertë dhe me përfaqësuesin e Ministrisë së Drejtësisë.

Struktura e kësaj analize korrespondon me strukturën e Ligjit për gjykata. Fillimisht, është dhënë një pasqyrë e parimeve themelore të gjykatave, me rekomandime kryesore dhe me vlerësimin e gjendjeve të prezantuara në Raportet e Komisionit Evropian (KE). Pastaj u shqyrtuan standardet dhe rekomandimet ndërkombëtare, gjendja në Republikën e Maqedonisë dhe opsionet, si dhe ndikimi i tyre mbi organizimin dhe kompetencën e gjykatave, gjyqtarëve dhe gjyqtarëve-porotë, ndërprerja dhe shkarkimi nga funksioni i gjyqtarit, sistemi informatikë gjyqësor dhe mjetet e punës së gjykatave. Në fund janë prezantuar pikëpamjet përfundimtare nga kjo analizë. U shqyrtua edhe procesi i vlerësimit të ndikimit të legjislacionit në vendet e Ballkanit.

12 Ndikimi i opsioneve shihej nga aspekti i qytetarëve si shfrytëzues të fundit, gjyqtarët, gjykatat dhe shërbimi gjyqësor.

13 Në këtë hulumtim u përdor metodologjia e miratuar nga ana e Qeverisë së RM ("Gazeta Zyrtare e RM", nr. 107/13) dhe manuali për vlerësimin e ndikimit të legjislacionit në Ministrinë për Shoqëri Informatike dhe Administratë.

14 Fokus grupet u realizuan në muajin tetor 2018, ndërsa intervistat u realizuan nga muaji tetor, përfundimisht me muajin nëntor të vitit 2018.

1. PARIMET THEMELORE

Parimet themelore mbi të cilat bazohet procedura gjyqësore¹⁵ në Republikën e Maqedonisë janë principe të cilat korrespondojnë me standardet ndërkombëtare për gjykim të ndershëm të sanksionuara në shumë dokumente ndërkombëtare. Implementimi konsekuent i këtyre parimeve është në interes të avancimit të të drejtave të njeriut, ndërsa nga ana tjetër kontribuon në drejtim të proceseve eu-rointeguese të vendit.

Sipas Ligjit për gjykata¹⁶ gjykatat janë organe të pavarura dhe të mëvetësishme shtetërore të cilat gjykojnë dhe marrin vendime në përputhje me Kushtetutën, ligjet dhe marrëveshjet ndërkombëtare. Në punën e tyre, gjykatat e kanë për detyrë ta aplikojnë të drejtën në mënyrë të paanshme, pavarësisht statusit social dhe cilësisë së palëve, të sigurojnë barazi, barabarësi dhe mosdiskriminim mbi çfarëdo qoftë baze dhe t'u sigurojnë siguri juridike qytetarëve dhe me këtë edhe sundimin e së drejtës në vend.

Procedura në gjyq rregullohet me ligj dhe bazohet mbi parimet si vijojnë: ligjshmëri dhe legjitimitet, barazia e palëve, gjykim në afat të arsyeshëm, drejtësi, transparencë dhe publicitet, kontradiktë, dyshkallësi, e drejta e fjalës, e drejta e shprehjes, të qenit të drejtpërdrejt, e drejta e mbrojtjes, përkatësisht e avokimit, vlerësim i lirë i provave dhe ekonomizimi.

Pavarësia e gjykatave në Republikën e Maqedonisë garantohet me Kushtetutë si akti më i lartë juridik në shtetin tonë.

Në këtë kapitull është prezantuar një pasqyrë e detajuar e masave të buta të Këshillit të Evropës të cilat kanë të bëjnë me transparencën, pavarësinë, efikasitetin dhe gjykimin në afat të arsyeshëm. Pasqyra e secilit prej këtyre parimeve shoqërohet me pasqyrën e përmbajtjes së rekomandimeve nga Komisioni Evropian në raportet e progresit të RM-së ndër vite.

¹⁵ Ligjshmëri dhe legjitimitet, barazia e palëve, gjykimi në afat të arsyeshëm, drejtësi, publicitet dhe transparencë, kontradiktë, dy shkallësi, e drejta e fjalës, e drejta e shprehjes drejtpërdrejt, e drejta e mbrojtjes përkatësisht përfaqësimit, liria e vlerësimit të provave dhe ekonomizimi.

¹⁶ Ligji për gjykata, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr.58/06, 35/08, U.nr.256/07, U.nr.74/08,150/10, U.nr.12/11), (tekst i konsoliduar)

1.1. Transparenca

Puna transparente e organeve gjyqësore është e rëndësishme për ndërtimin e besimit të qytetarëve tek gjyqësori dhe për fuqizimin e legjitimitetit të gjyqësorit si shtylla e tretë e pushtetit. Me Strategjinë e re për reformë të sektorit të jurispruencës 2017-2022¹⁷, Qeveria si synime i përcaktoi: përf forcimin e mekanizmave të transparencës, llogaridhënies dhe përgjegjësisë së gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Nga pikëpamja kohore, në lidhje me publikimin e vendimeve gjyqësore, me ndryshimet e Ligjit për Gjykata nga viti 2010, gjykatat e kanë për detyrë që vendimet e miratuara, në afat prej dy ditësh nga dita e përpilimit dhe nënshkrimit, t'i publikojnë në ueb faqen e gjykatës.¹⁸ Sa i përket aksesit të aktgjykimeve me inkorporimin e këtyre ndryshimeve ligjore u imponua nevoja e inkorporimit të klasifikimit¹⁹ të aktgjykimeve sipas lëndëve dhe inkorporimit të funksioneve lehtësisht të aksesshme²⁰ për kërkimin e aktgjykimeve të publikuara në ueb faqen e gjykatave. Në vitin 2014 Komisioni Evropian vlerësoi se nuk janë ndërmarr hapa për përmirësimin e funksionit të shfrytëzimit, ndërsa nga ana tjetër krahas obligimit ligjor që të sigurohet transparencë përmes publikimit të të gjitha aktgjykimeve gjyqësore, në afat prej 2 ditësh nga përpilimi dhe nënshkrimi, aktgjykimet më të rëndësishme ose kontroverse për të cilat mund të ketë interesim nga publiku, nuk publikohen fare e që paraqet mungesë të informacioneve të verifikuara dhe raportime të shtrembëruara mediatike.²¹ Sa i përket përmirësimit të transparencës, por edhe t'u përgjigjet pyetjeve të "Prioriteteve Urgjente të Reformave" të vendosura nga Komisioni Evropian²², u lëshua në përdorim portali i ri gjyqësor - www.sud.mk i cili i përmban informacione për të gjitha gjykatat në Republikën e Maqedonisë. Njëra nga masat e parashikuara me Strategjinë për reformë të sektorit të jurispruencës është azhurnimi i rregullt i kësaj baze të të dhënave.²³ Megjithatë, informacionet e postuara në këtë bazë të të dhënave dallojnë varësisht nga gjykata dhe nga konsistenca e saj, madje edhe sa u përket të dhënave të aksesshme statistikore. *Duhet të azhurnohet ky portal duke e pasur parasysh faktin se edhe për momentin ekziston një numër i madh i të ashtuquajturave lidhje "të vdekura" (linqe) të cilat nuk na çojnë askund.*

Në drejtim të rritjes së transparencës së gjykatave, si parim kryesor i parashikuar në Ligjin për gjykata në vitin 2010 me ndryshimet e Ligjit për gjykata, u inkorporua formimi i detyrueshëm i zyrës për marrëdhënie me publikun në gjykata²⁴

17 Strategjia për reformë të sektorit të jurispruencës për periudhën kohore 2017 – 2022 me Plan veprim, e aksesshme në: <http://www.pravda.gov.mk/Upload/Documents/2017-2022.pdf>

18 "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 150 nga data 18.11.2010

19 Raport i Komisionit Evropian për Republikën e Maqedonisë për vitin 2012, i aksesshëm në: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2012/package/mk_rapport_2012_en.pdf

20 Raport i Komisionit Evropian për Republikën e Maqedonisë për vitin 2013, i aksesshëm në: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2013/package/brochures/the_former_yugoslav_republic_of_macedonia_2013.pdf

21 Raport i Komisionit Evropian për Republikën e Maqedonisë për vitin 2014, i aksesshëm në: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2014/20141008-the-former-yugoslav-republic-of-macedonia-progress-report_en.pdf

22 Prioritetet Urgjente të Reformave për Republikën e Maqedonisë, qershor 2015, i aksesshëm në: https://eeas.europa.eu/sites/eeas/files/urgent_reform_priorities_en.pdf

23 Strategjia për reformë të sektorit të jurispruencës për periudhën kohore 2017 -2022 me Plan Veprim, e aksesshme në: <http://www.pravda.gov.mk/Upload/Documents/29.11.2017AkckskiPlannovo%20za%20veb.pdf>

24 "Gazeta Zyrtare e RM", nr. 150 të datës 18.11.2010

Komisioni Evropian, në vitin 2011, vëren se janë hapur zyra për marrëdhënie me publikun²⁵, ndërsa në portalin e gjykatave janë cekur personat për kontakt të cilët janë të ngarkuar për komunikim me publikun. Mund të adresohen vërejtje kritike edhe në lidhje me kanalet interne të zhvilluara në nivel të pamjaftueshëm në lidhje me implementimin e politikës së marrëdhënies me publikun dhe komunikimit midis trupave udhëheqëse në jurisprudencë, si dhe mosekzistimi i më shumë kanaleve formale dhe kapaciteteve të gjyqësorit/prokurorisë publike që të komunikojnë në mënyrë efektive me pushtetin ligjvënës dhe me degët e tjera të pushtetit lidhur me çështjet më të rëndësishme strategjike dhe operative. Në periudhën e kaluar u caktuan persona të ngarkuar për marrëdhënie me publikun në të gjitha gjykatat, ndërsa në Gjykatën Themelore në Shkup 1 dhe Shkup 2, Gjykatën Supreme, Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë dhe në Prokurorinë Publike të Republikës së Maqedonisë u punësuan persona profesionistë të ngarkuar për marrëdhënie me publikun – zëdhënës. Kjo masë, mesa duket, nuk është e mjaftueshme për një transparencë konsekuente në punën e gjykatave. Për shkak të situatës së konstatuar të këtyllë njëra nga masat e parashikuara në Strategjinë është fuqizimi i kapaciteteve për marrëdhënie me publikun.²⁶

1.2. Efikasiteti dhe gjykimi në afat të arsyeshëm

Efikasiteti i gjyqtarëve dhe sistemit gjyqësor është kusht i domosdoshëm për mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve. Sipas Rekomandimit CM/REC(2010)12²⁷ të Këshillit të Evropës, me efikasitet nënkuptohet miratimi i vendimeve cilësore gjyqësore në afat të arsyeshëm të shoqëruara me shqyrtim të ndershëm të të gjitha çështjeve të lëndëve gjyqësore. Çdo gjyqtar si individ e ka për detyrë të siguroj administrim efikas me lëndët e ndara, duke e përfshirë edhe ekzekutimin e vendimeve që është në kompetencë të tyre. *Autoritetet përgjegjëse për organizimin dhe funksionimin e sistemit gjyqësor, e kanë për detyrë t'u sigurojnë kushte gjyqtarëve të cilat do t'u mundësojnë t'i përmbushin detyrat e tyre në mënyrë efikase, njëkohësisht duke e mbrojtur pavarësinë dhe paanshmërinë e tyre.*

Problemi me lëndët e prapambetura u përcaktua me Strategjinë për reformë të sistemit të jurisprudencës 2004-2007 dhe njëri nga objektivat e kësaj Strategjie ishte pikërisht avancimi i efikasitetit të jurisprudencës.²⁸ Si rezultat i një sërë masash për rritjen e efikasitetit, gradualisht janë eliminuar lëndët e prapambetura nëpër gjykata, e që në vitin 2014 e vlerësoi edhe Komisioni Evropian.²⁹ Sa i përket gjykimit në afat të arsyeshëm në Raport progresin e Komisionit Evropian për vitin

25 Raport i Komisionit Evropian për Republikën e Maqedonisë për vitin 2011, i aksesshëm në: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2011/package/mk_raport_2011_en.pdf

26 Strategjia për reformë të sektorit të jurisprudencës për periudhën kohore 2017 -2022 me Plan Veprim, e aksesshme në:<http://www.pravda.gov.mk/Upload/Documents/29.11.2017AkciskiPlannovo%20za%20veb.pdf>

27 Këshilli i Evropës, Gjyqtar: Pavarësi, efikasitet dhe përgjegjësi, Rekomandim CM/Rec (2010)12 dhe memorandum shpjegues, I aksesshëm në: <https://rm.coe.int/16807096c1>

28 Strategjia për reformë të sektorit të jurisprudencës për periudhën kohore 2017 -2022 me Plan Veprim, f. 4

29 Raport i Komisionit Evropian për Republikën e Maqedonisë për vitin 2014, i aksesshëm në: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2014/20141008-the-former-yugoslav-republic-of-macedonia-progress-report_en.pdf

2013 u konstatua se ekziston problem me procedurat e tej zgatuara gjyqësore, duke i përfshirë edhe aktgjykimet e shfuqizuara të përsërita dhe pagesat për rigjykim ose për seanca të përsëritura dëgjimore nga ana e gjykatave më të larta drejt gjykatave më të ulëta.³⁰Fazat individuale të procedurave gjyqësore në përgjithësi janë kryer në afatet ligjore; megjithatë, kohëzgjatja e përgjithshme e procedurave gjyqësore nga inicimi deri në aktgjykimin përfundimtar paraqet problem në disa kategori të lëndëve. Megjithatë, në Raportin e fundit të Komisionit Evropian nga viti 2018 u konstatua se problemet me kohëzgjatjen e përgjithshme të procedurave gjyqësore tani kanë të bëjnë vetëm për një numër të kufizuar të lëndëve që zhvillohen sipas rregullave të vjetra procedurale.³¹ Shkalla e lëndëve të zgjidhura në shumicën e gjykatave është 100% që do të thotë se gjykatat tani janë në gjendje t'i bëjnë ballë prurjes së lëndëve të reja brenda një viti, kështu që tanimë disa vjet lëndët e pazgjidhura gjyqësore nuk paraqesin problem të rëndësishëm. Për një numër të lëndëve të prapambetura të cilat akoma nuk janë zgjidhur Këshilli Gjyqësor në bashkëpunim me kryetarët e gjykatave miratoi Strategji për zgjidhjen e tyre me projektion dhe propozim masa për tejkalimin e gjendjeve.³² Masat e definuara në Strategji, në lidhje me lëndët e prapambetura, konsistojnë me atë që në gjykatat të formohen trupa funksional të punës të cilat do ta monitorojnë gjendjen e lëndëve të prapambetura dhe të pazgjidhura dhe të përpilojnë propozim – plan për tejkalimin e zgjidhjes së lëndëve dhe inkorporimin e instrumenteve të veçanta për identifikimin dhe dhënien prioritet të lëndëve të cilat mund të rezultojnë me cenimin e parimit të gjykimit në afat të arsyeshëm.³³

1.3. Pavarësia dhe paanshmëria e gjyqtarëve

Sipas Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut³⁴, gjatë përcaktimit të të drejtave dhe detyrimeve qytetare ose të çdo aktakuze, gjithsecili ka të drejtë për seancë të ndershme dhe transparente gjyqësore në afat të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e themeluar me ligj.

Si karakteristikë e sundimit të së drejtës, pavarësia e gjyqësorit duhet të garantohet në aktin më të lartë juridik të një vendi, përkatësisht në Kushtetutën e shtetit, në ato shtete të cilat kanë kushtetuta të shkruara.³⁵ Pavarësia e jurisprudencës

30 Raport i Komisionit Evropian për Republikën e Maqedonisë për vitin 2013, i aksesshëm në:https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2013/package/brochures/the_former_yugoslav_republic_of_macedonia_2013.pdf

31 Raport i Komisionit Evropian për Republikën e Maqedonisë për vitin 2013, i aksesshëm në: <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20180417-the-former-yugoslav-republic-of-macedonia-report.pdf>. Këtë qëndrim e ka edhe Komisioni i Venecias dhe Komiteti i Ministrave [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2010\)004-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2010)004-e); <https://rm.coe.int/16807096c1>

32 Strategjia për reformë të sektorit të jurisprudencës për periudhën kohore 2017 -2022, i aksesshëm në:<http://www.pravda.gov.mk/Upload/Documents/2017-2022.pdf>

33 Ibid.

34 https://www.echr.coe.int/Documents/Convention_ENG.pdfArt. 6

35 Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Evropian, Pasqyrë e mendimeve të Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve të Evropës. Mars 2015, f. 3, i aksesshëm në:<https://rm.coe.int/1680702110>

trajtohet si e jashtme dhe e brendshme.³⁶ Pavarësia e jashtme e përcakton lidhjen ndërmjet pavarësisë së gjyqtarëve dhe parimit të barazisë së qytetarëve para ligjit. Aspektet kryesore të saj janë ndarja kushtetuese e pushtetit dhe marrëdhëniet me mediat. Pavarësia e brendshme nënkupton pavarësi të çdo gjyqtari gjatë ushtrimit të funksionit të gjyqtarit, pa kurrfarë kufizimi, ndikimi jopërkatës, presione, kërcënime ose ndërhyrje nga cilido qoftë pushtet, duke e përfshirë edhe gjyqësorin, gjatë miratimit të vendimeve. Pavarësia e gjyqësorit duhet të garantohet nga një trup i pavarur me qëllim që të jetë efektiv. Trupi i këtillë do të ishte kompetent për përcaktimin e rregullave të zgjedhjes, avancimit të gjyqtarëve, evaluimit dhe trajnimit të gjyqtarëve, si dhe për vlerësimin e cilësisë së sistemit gjyqësor dhe mënyrës së funksionimit të tij. Paanshmëria nënkupton veprim profesional ndaj lëndëve të ndara dhe sigurim të integritetit të profesionit. Duhet të parandalohet konflikti i interesave. Sistemi i ndarjes së lëndëve tek gjyqtarët është mjaft i rëndësishëm. Pritet vendosja dhe respektimi i kodeksit të etikës së gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë.³⁷

Edhe pse pavarësia e gjyqtarëve është e garantuar dhe parashikuar me ligj, megjithatë gjendja me pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqtarëve maqedonas në RM vlerësohet se shënon kthim pas nga viti 2014³⁸ meqë arrijtjet e proceseve reformuese nga dekada e fundit seriozisht u rrënuan nga ndërhyrja e atëhershme politike në punën e gjyqësorit. Edhe pse në pjesën më të madhe të lëndëve të “zakonshme”, gjykatat mund të veprojnë në mënyrë të pavarur, megjithatë ekzistojnë raporte të përsëritura për drejtësi selektive dhe ndërhyrje politike në lëndë të caktuara të profilit të lartë ose në lëndë sensitive politike gjyqësore.

Në raportin e fundit nga viti 2018³⁹, Komisioni Evropian vlerëson se procesi retrograd në vitet e kaluara ka filluar të përmirësohet përmes hapave të vendosur që u ndërmorën muajve të fundit, veçanërisht në drejtim të jetësimit të pavarësisë së gjyqësorit. Kjo i referohet Strategjisë së sapo miratuar për reformë të sektorit të jurisprudencës 2017-2022⁴⁰, e cila e vë bazën e reformave të ardhshme në këtë fushë, ndërsa ligjet kryesore janë amenduar në përputhje me rekomandimet e Komisionit të Venecias dhe “Prioritetet Urgjente të Reformave”.

Megjithatë, akoma nuk kemi rritje të besimit nga ana e qytetarëve në sistemin e jurisprudencës. Sipas rezultateve nga hulumtimet e fundit të realizuara nga “Rrjeti 23”, 62% e qytetarëve nuk kanë besim në sistemin e jurisprudencës ndërsa 54% e tyre janë të mendimit se gjendja në jurisprudencë është e keqe.⁴¹

36 Standardet për pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqësorit të përkufizuara nga dokumentet e Këshillit të Evropës dhe të postuara në MK – BE Qendra e Resurseve <http://www.merc.org.mk/oblast/2/pravosudstvo>

37 Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Evropian, Pasqyra e opinioneve të Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Evropian, Mars 2015, f. 3, i aksesshëm në: <https://rm.coe.int/1680702110>

38 Raport i Komisionit Evropian për Republikën e Maqedonisë për vitin 2018, i aksesshëm në: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2014/20141008-the-former-yugoslav-republic-of-macedonia-progress-report_en.pdf

39 Raport i Komisionit Evropian për Republikën e Maqedonisë për vitin 2018, i aksesshëm në: <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20180417-the-former-yugoslav-republic-of-macedonia-report.pdf>

40 Strategjia për reformë të sektorit të jurisprudencës për periudhën kohore 2017 – 2022, e aksesshme në: <http://www.pravda.gov.mk/Upload/Documents/2017-2022.pdf>

41 http://epi.org.mk/docs/Mreza23_izvestaj%20vo%20senka_2018.pdf

Në këtë drejtim në Strategji janë përfshirë jokonsekuencat në lidhje me pavarësinë dhe paanshmërinë e sistemit të jurisprudencës, ndërsa njëri nga qëllimet strategjike është pikërisht avancimi i pavarësisë dhe paanshmërisë së sistemit të jurisprudencës. Në Strategji janë parashikuar një varg masash që kanë të bëjnë me zgjedhjen e gjyqtarëve, përcaktimin e kriterëve të përforcuara për anëtarë të Këshillit Gjyqësor, në mesin e të cilave edhe përcaktimi i nocionit “jurist i shquar”, funksionimi i drejt i sistemit AKMIS dhe realizimi i tij, si dhe buxhet i pavarur dhe i qëndrueshëm gjyqësor, konsistent ndaj përcaktimit ligjor të bruto të ardhurave nacionale.⁴²

42 Strategjia për reformë të sektorit të jurisprudencës për periudhën kohore 2017 – 2022, e aksesshme në:<http://www.pravda.gov.mk/Upload/Documents/2017-2022.pdf>

2. ORGANIZIMI DHE KOMPETENCA

2.1 Analiza e dokumenteve dhe standardeve ndërkombëtare

Qasja në gjykatë është parim bazik dhe elementi kryesor i aksesit deri te drejtësia. Prandaj nevojitet të shqyrtohet organizimi i sistemit gjyqësor në territorin e shtetit dhe në çmënyrë palët mund të kenë qasje fizike deri te gjyqtari. Variabla të dobishme në këtë drejtim është dendësia gjeografike e vendit, si dhe distanca e udhëtimit të qytetarëve deri te gjykatat. Disa shtete kanë sistem gjyqësor të koncentruar dhe numër të vogël të gjykatave të mëdha, ndërsa vende të tjera nga aspekti i shtrirjes gjeografike kanë gjykata më të vogla. Që të vlerësohet rrjeti gjyqësor, para së gjithash, propozohet të shqyrtohet numri i përgjithshëm i lokacioneve gjeografike të gjykatave.⁴³

Struktura e rrjetit gjyqësor është problem i baraspeshës midis faktorëve të ndryshëm si vijojnë:

- Qasja deri te drejtësia sa i përket afërsisë së qytetarëve me gjykatat.
- Madhësia minimale e gjykatës me qëllim të sigurimit të kompetencave dhe funksioneve të ndryshme.
- Reduktimi i shpenzimeve si resurse të administratës publike, të cilat nuk mundet dhe nuk duhen të shpenzohen dhe optimizimi i tyre.
- Maksimizimi i cilësisë së gjykatës dhe dhënia përkatëse e shërbimeve.⁴⁴

43 Komisioni Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë, Sistemi Gjyqësor Evropian Efikasiteti dhe Kualiteti i Drejtësisë, nr. 26, 2018, f. 206

44 Komisioni Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë, Udhëzues i reviduar për krijimin e hartave gjyqësore, 2013, i aksesshëm në: https://rm.coe.int/european-commission-for-the-efficiency-of-justice-cepej-revised-guidel/168078c492#_Toc356475577

Shqyrtimi i hartave të gjyqësorit zakonisht përfundon me vendim për atë se cilat gjykata duhet të mbeten dhe cilat duhet të mbyllen. Prandaj, autoritetet duhet t'i vlerësojnë me kujdes nevojat për drejtësi në juridiksionet e tyre dhe të zbatojnë dhe të aplikojnë rregulla homogjene. Në këtë drejtim, Komisioni Evropian për efikasitetin e drejtësisë thekson se ekzistojnë shumë indikatorë të cilët mund të shfrytëzohen që të përcaktohet baraspesha optimale ndërmjet aktivitetit të gjykatave dhe afërsisë së gjykatave me palët/ qytetarët si shfrytëzues të fundit.⁴⁵ Ky Komision e jep shembullin me Italinë, me ç'rast për ta marrë vendimin se cilat gjykata të shkallës së parë duhet të mbyllen është matur aktiviteti i zyrave dhe produktiviteti i gjyqtarëve dhe gjykatave duke shfrytëzuar limite specifike. Gjatë vendimmarrjes finale, fokusi është vënë mbi ata me madhësi të kufizuar dhe rezultate të dobëta, që vlerësohet kundrejt nivelit mesatar të indikatorëve për efikasitetin e periudhës pesëvjeçare para reformës. Gjatë këtij operacioni, është konsideruar se gjykatat me vlera të arritshme të indikatorëve shumë nën mesataren aritmetike mund të kenë dobi nga xhiroja ekonomike nëse bashkohen me gjykata më të mëdha dhe më produktive.⁴⁶

Në këtë drejtim Komisioni Evropian për efikasitetin e drejtësisë i vë në dukje faktorët më esencial për përkufizimin dhe analizën e drejtë të rrjeteve gjyqësore. Ato janë ndarë në dy kategori kryesore: "faktorë kryesorë", të cilët janë me rëndësi primare dhe "faktorë shtesë" të cilët janë me rëndësi sekondare të cilët nëse shfrytëzohen do ta rrisin aspektin themelor dhe integral të analizës. Faktorët kyç janë indikatorë të qartë kuantitativ ose indikatorë lehtësisht të matshëm të cilët ofrojnë një shkallë më të lartë të objektivitetit. Nga ana tjetër, në mesin e faktorëve shtesë, disa janë indikatorë kualitativ të cilët edhe pse është e mundur nuk janë lehtësisht të matshëm (për shembull, niveli i biznesit, praktika e rekrutimit të gjyqtarëve dhe personelit, etj.). Disa nga faktorët plotësues kanë ndikim të vogël (si ndërmjetësimi ose sofistikimi kulturor). Prandaj, është më mirë të merren parasysh edhe faktorët plotësues si plotësim të kritereve kyç, me qëllim që të ndërtohen reforma më të forta.⁴⁷

Faktorët kyç

1. Dendësia e popullsisë
2. Madhësia e gjykatës
3. Rrjedha e procedurave dhe vëllimi i punës
4. Lokacioni gjeografik, infrastruktura dhe transporti

Faktorë plotësues

1. Kompjuterizimi
2. Infrastruktura e gjykatave, pajisja e nevojshme (telefon / video) dhe sofistikimi kulturor
3. Niveli i biznesit
4. Zgjidhja alternative e kontesteve / ndërmjetësimi
5. Aksesi i këshillave juridike dhe rekrutimi i gjyqtarëve dhe personelit
6. Bashkëpunimi me sistemet e jashtme (burgje, shërbimi i prokurorisë, policia)

45 Ibid.

46 Ibid.

47 Ibid.

Komisioni Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë në “Sistemin gjyqësor evropian efikasiteti dhe kualiteti i drejtësisë” edicioni 2018, ofron tabelë me pasqyrë të numrit të gjykatave të shkallës së parë si persona juridikë dhe numrin e të gjitha gjykatave si lokacione gjeografike në vitin 2016. Sipas kësaj tabele Republika e Maqedonisë është në kuadrin e mesatares së përcaktuar. E njëjta ka të bëjë edhe me tabelën me pasqyrë të numrit të gjykatave të shkallës së parë, me kompetencë të përgjithshme dhe me numër të gjykatave të specializuara të shkallës së parë në vitin 2016 në numra absolut për 100 000 banorë.⁴⁸ Si gjykata me kompetencë të përgjithshme janë kategorizuar të gjitha gjykatat, pavarësisht se a janë me kompetencë të përgjithshme ose të zgjeruar.

2.2 Gjendjet në Republikën e Maqedonisë në lidhje me strukturën e rrjetit të sistemit gjyqësor

Me ligjin e vitit 1995⁴⁹ në sistemin unik gjyqësor, pushtetin gjyqësor e ushtrojnë gjykatat themelore të apelit dhe Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë. Me këtë ligj, veç tjerash, u bë distinkcioni midis gjykatave me kompetencë themelore, me ç’rast kompetenca për gjykimin e lëndëve të caktuara më të vështira dhe të specializuara⁵⁰ iu përcaktua vetëm disa gjykatave.⁵¹ Megjithatë, me Ligjin për gjykata në vitin 2006, gjykatat u ndan në gjykata me kompetencë themelore dhe të

48 Komisioni Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë, Sistemi Gjyqësor Evropian Efikasiteti dhe Kualiteti i Drejtësisë, edicioni 2018, i aksesshëm në: <https://rm.coe.int/rapport-avec-couv-18-09-2018-en/16808def-9c#page=197&zoom=100,0,176>

49 Në përputhje me nenin 24 nga Ligji për gjykata, “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 36/95 të datës 27.07.1995.

50 Kompetenca e këtillë ishte përcaktuar për: a) gjykim në shkallë të parë dhe kryerja e punëve në procedurë penale për vepra penale për të cilat është përcaktuar dënim me burgim mbi dhjetë vjet dhe b) shkelje ekonomike, konteste pronësore dhe konteste të tjera civile – juridike në të cilat si palë paraqiten komunat, Qyteti i Shkupit dhe Republika, posedues të dyqaneve dhe persona të tjerë të cilët bëjnë regjistrimin e veprimtarisë afariste, konteste të personave juridikë vendor dhe të personave të huaj fizikë, dhe ndërmjet personave të huaj fizikë dhe juridikë, procedurë të falimentimit, kompensim i detyrueshëm dhe likuidim dhe konteste që do të ndodhin me këtë rast, konteste për ndryshime statusore (ndarje, bashkim, bashkëngjitje dhe organizim) dhe ekzekutim të vendimeve të atyre gjykatave, vendos edhe për ligjshmërinë e aktit të veçantë në kontestet administrative – kontabiliste, për mbrojtje për shkak të veprimeve të paligjshme, për pranimin dhe lejimin e ekzekutimit të vendimeve të gjykatave të huaja, si dhe të kryejnë punë të ndihmës ndërkombëtare juridike nëse me ligj nuk është përcaktuar kompetenca e një organi tjetër.

51 Kompetenca e këtillë me Ligjin për gjykatat nga viti 1995 iu përcaktua: Gjykatës Themelore në Manastir edhe për lëndët e juridiksionit të Gjykatës Themelore në Resnjë; Gjykatës Themelore në Kumanovë dhe për lëndët e juridiksionit të Gjykatës Themelore në Kratovë dhe Kriva Pallankë; Gjykatës Themelore në Prilep dhe për lëndët e juridiksionit të Gjykatës Themelore në Krushevë; Gjykatës Themelore në Strumicë dhe për lëndët nga juridiksioni i Gjykatës Themelore në Radovish; Gjykatës Themelore në Shtip dhe për lëndët nga juridiksioni i Gjykatës Themelore Sveti Nikollë; Gjykatës Themelore Koçan për lëndët e juridiksionit të gjykatave themelore në Berovë, Vinicë dhe Dellçevë; Gjykatës Themelore në Kavadar dhe për lëndët e juridiksionit të Gjykatës Themelore në Negotinë; Gjykatës Themelore në Gostivar dhe për lëndët nga juridiksioni i Gjykatës Themelore në Dibër; Gjykatës Themelore në Tetovë për juridiksionin e Komunës së Tetovës; Gjykatës Themelore në Veles për juridiksionin e Komunës Veles; Gjykatës Themelore Gjevgjeli për juridiksionin e komunave Gjevgjeli dhe Vallandovë; Gjykatës Themelore në Kërçovë për juridiksionin e komunës Kërçovë dhe Makedonski Brod; Gjykatës Themelore në Ohër për juridiksionin e Komunës së Ohrit; Gjykatës Themelore në Strugë për juridiksionin e Komunës së Strugës; Gjykatës Themelore Shkup 1 për juridiksionin e komunës Qendër dhe Karposh dhe Gjykatës Themelore Shkup 2 për juridiksionin e komunës Gazi Babë, Kisella Vodë dhe Çair.

zgjeruar. Një pjese e gjykatave të cilat deri atëherë ishin kompetente të vendosin për lëndë më të vështira konform ligjit paraprak kjo kompetencë iu hoq.⁵² Me ligjin nga viti 2006 iu dha kompetencë më e madhe reale gjykatave me kompetencë të zgjeruar, me ç'rast u zgjerua vëllimi i vendimmarrjes për lëndë të caktuara, për të cilat deri atëherë ishin kompetente të gjitha gjykatat themelore në rajonin e RM.

Në kapitullin 2 të Ligjit për gjykata është rregulluar organizimi dhe kompetenca e gjykatave në Republikën e Maqedonisë.⁵³ Në sistemin gjyqësor pushtetin gjyqësor e ushtrojnë 27 gjykata themelore, 4 gjykata të apelit, Gjykata Administrative, Gjykata e Lartë Administrative dhe Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë. Për dallim nga zgjidhja paraprake e Ligjit për gjykata nga viti 1995,⁵⁴ me ligjin nga viti 2006 gjykatat themelore, në përputhje me kompetencën reale gjykojnë në shkallë të parë dhe themelohen si gjykata me kompetencë themelore dhe gjykata me kompetencë të zgjeruar. Në kuadër të gjykatave themelore me kompetencë të zgjeruar detyrimisht themelohen departamente të specializuara gjyqësore që do të veprojnë për konteste të caktuara. Gjykatat themelore mund të kenë seksione gjyqësore, të gjykojnë jashtë selisë së gjykatës, si dhe të kenë ditë gjykimi jashtë selisë së gjykatës.⁵⁵ Me Ligjin për gjykata nga vitit 2006 gjykatat themelore u ndan në gjykata me kompetencë themelore dhe në gjykata me kompetencë të zgjeruar, në mënyrë plotësuese u instalua edhe Gjykata e Specializuar – Gjykata Administrative.⁵⁶ Me këtë ligj u përcaktua formimi i seksioneve të specializuara gjyqësore në gjykatat themelore në Manastir, Tetovë, Shkup 1, Strumicë dhe Shtip, kompetente për gjykimin e veprave nga fusha e krimit të organizuar. Me ndryshimet e ligjit nga viti 2008 një seksion i këtillë i specializuar është parashikuar vetëm në Gjykatën Themelore Shkup 1. Në mënyrë plotësuese, me ndryshimet e vitit 2008 këtij seksioni i jepen kompetenca për të gjykuar më shumë lëndë të cilat deri atëherë ishin në kompetencë të gjykatave me kompetencë të zgjeruar. Ndryshimi i tretë i rëndësishëm në lidhje me strukturën organizative të ligjit nga viti 2006 u bë me instalimin e Gjykatës së Lartë Administrative me ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për gjykata nga viti 2010.⁵⁷ Me këto ndryshime kompetenca e Gjykatës Supreme që të vendos sipas ankesave të Gjykatës Administrative iu delegua Gjykatës së Lartë Administrative.

Të dhënat statistikore tregojnë⁵⁸ se ekziston prurje e pabarabartë e lëndëve nëpër gjykata (grafiku 1). Nga ana tjetër, ka dallim të madh në lidhje me kohëzgjatjen mesatare të lëndëve llogaritur sipas ditëve (grafiku 2). Sa i përket numrit të përgjithshëm të lëndëve në punë nga gjykatat veçohen disa gjykata me kompetencë

52 Kompetenca për vendimmarrje sipas lëndëve më të rënda i është hequr Gjykatës Themelore në Kavadar, Gjykatës Themelore në Gjevgjeli, Gjykatës Themelore në Kërçovë.

53 Ligji për gjykatat "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 58/2006, 62/2006, 35/2008, 150/2010, 83/2018 dhe 198/2018


54 Në përputhje me nenin 24 të Ligjit për gjykata "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 36/95 nga 27.07.1995, në sistemin unik gjyqësor, pushtetin gjyqësor e ushtrojnë gjykatat themelore, të apelit dhe Gjykata Supreme e R. së Maqedonisë.

55 Neni 22 dhe neni 23, të Ligjit për gjykatat, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 58/2006, 62/2006, 35/2008, 150/2010, 83/2018 dhe 198/2018

56 http://epi.org.mk/docs/Mreza23_izvestaj%20vo%20senka_2018.pdf



57 Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për gjykata, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 150/2010

58 Të dhënat statistikore lidhur me lëndët në gjykata dhe kohëzgjatja e procedurave sipas ditëve, u siguruan me kërkesë për qasje të lirë deri te informacionet me karakter publik pranë Këshillit Gjyqësor. Të dhënat janë pasqyruar në ANEKSIN 1 të kësaj analize.




themelore lidhur me lëndët në krahasim me gjykatat e tjera (grafiku 3). Këto janë: Gjykata Themelore Kërçovë, Gjykata Themelore Gjevgjeli dhe Gjykata Themelore Kavadar. Gjykata Themelore Radovish vjen menjëherë pas këtyre gjykatave. Këto gjykata, në total kanë përafërsisht numër të njëjtë të lëndëve në punë si disa gjykata me kompetencë të zgjeruar. Së këtejmi, këto gjykata kanë edhe numër më të madh të gjyqtarëve (Tabela 1) nga disa prej gjykatave me kompetencë të zgjeruar. Numër më të madh të lëndëve në punë ka Gjykata Themelore Shkup 1, menjëherë pas saj është Gjykata Themelore Shkup 2 (Grafiku 3). Numër më të vogël të numrit të përgjithshëm të lëndëve në punë për një gjyqtar nga gjykatat themelore ka Gjykata Themelore në Kratovë, menjëherë pas saj është Gjykata Themelore e Krushevës (Grafiku 3). Prurje më të madhe të lëndëve ka Gjykata Themelore Shkup 1 (Grafiku 1). Mbingarkim më të madh me lëndë dhe kohëzgjatje mesatare më të lartë të lëndëve sipas ditëve nga gjykatat e apelit ka Gjykata e Apelit në Shkup (Grafiku 2 dhe Grafiku 3). Kohëzgjatje mesatare më të madhe të lëndëve nga të gjitha gjykatat në RM ka Gjykata Administrative, menjëherë pas saj është Gjykata e Apelit në Shkup (Grafiku 2).

Grafiku 1: Lëndë të pranuar në gjykata në vitin 2015, 2016 dhe 2017



Grafiku 2: Kohëzgjatja e procedurave sipas ditëve në gjykata



Grafiku 3: Gjithsej lëndë në punë në gjykata sipas viteve






Tabela 1 – Numri i gjyqtarëve konform vendimit të Këshillit Gjyqësor të RM dhe numri aktual i gjyqtarëve

Gjykata	Numri i gjyqtarëve sipas Vendimit të Këshillit Gjyqësor të RM nga viti 2015 (me kryetarin)	Numri aktual i gjyqtarëve në gjykata (me kryetarin)	Dallimi
Gjykata Supreme e RM	25	17	8
Gjykata e Lartë Administrative	13	12	1
Gjykata Administrative	33	27	6
Gjykata e Apelit Manastir	25	22	3
Gjykata e Apelit Gostivar	16	15	1
Gjykata e Apelit Shkup	52	37	15
Gjykata e Apelit Shtip	16	14	2
Gjykata Themelore Manastir	25	18	7
Gjykata Themelore Krushevë	3	2	1
Gjykata Themelore Ohër	18	18	0
Gjykata Themelore Prilep	18	16	2
Gjykata Themelore Resnjë	4	3	1
Gjykata Themelore Strugë	15	14	1
Gjykata Themelore Gostivar	24	22	2
Gjykata Themelore Dibër	5	4	1
Gjykata Themelore Kërçovë	13	11	2
Gjykata Themelore Tetovë	26	26	0
Gjykata Themelore Veles	18	17	1
Gjykata Themelore Gjevgjeli	13	11	2
Gjykata Themelore Kavadar	10	9	1
Gjykata Themelore Kratovë	3	3	0
Gjykata Themelore Kriva Pallankë	6	6	0
Gjykata Themelore Kumanovë	34	30	4
Gjykata Themelore Negotinë	5	5	0
Gjykata Themelore Shkup 1 Shkup	70	56	14
Gjykata Themelore Shkup 2 Shkup	77	65	12
Gjykata Themelore Berovë	3	3	0
Gjykata Themelore Vinicë	3	3	0
Gjykata Themelore Dellçevë	4	3	1
Gjykata Themelore Koçan	10	8	2
Gjykata Themelore Radovish	6	6	0
Gjykata Themelore Sveti Nikollë	4	4	0
Gjykata Themelore Strumicë	20	14	6
Gjykata Themelore Shtip	19	15	4



Një pjesë e gjykatave ballafaqohen me mungesë të gjyqtarëve dhe kjo reflektohet në punën e gjykatave, disa nga gjykatat themelore me kompetencë themelore nuk do të mund të funksionojnë nëse nuk ka delegim nga ndonjë gjykatë tjetër. Me delegimin e gjyqtarëve nga gjykatat me kompetencë të zgjeruar në gjykatat me kompetencë themelore reduktohet cilësia në gjykatën konkrete nga e cila delegohet gjyqtari.⁵⁹ Në nëntor të vitit 2015, Këshilli Gjyqësor mori vendim për reduktimin e numrit të gjyqtarëve nga 740 në 557 pa u bërë vlerësimi i ndikimit.⁶⁰

Nga hulumtimi i realizuar në terren rezultoi se ekziston problem sa i përket strukturës së rrjetit të sistemit gjyqësor në Republikën e Maqedonisë edhe atë nga më shumë aspekte.⁶¹ Fillimisht ekziston prurje e pabarabartë të lëndëve në gjykata, veçanërisht në gjykatat me kompetencë themelore. Me këtë, gjyqtarët nuk janë në pozitë të barabartë gjatë notimit dhe avancimit. Ekziston një numër i vogël i gjyqtarëve në gjykata të caktuara të cilët gjithashtu kanë numër të vogël të lëndëve. Në mënyrë plotësuese me strukturën e këtyre organizative pamundësohet specializimi i gjyqtarëve sipas fushave, veçanërisht në gjykatat më të vogla.⁶² Delegimi i gjyqtarëve në disa gjykata të caktuara nuk e arriti qëllimin, meqë në këtë mënyrë, gjykatat me kompetencë të zgjeruar prej të cilave më së shpeshti delegohen gjyqtarë, humbin në cilësi. Kjo me vete bart edhe shpenzime të rritura për palët sa i përket udhëtimit deri në gjykatat me kompetencë të zgjeruar. **Probleme shtesë krijon edhe mbrojtja e të drejtave të fëmijëve të cilët janë në konflikt me ligjin për cilët janë kompetente gjykatat me kompetencë të zgjeruar.**⁶³ Një pjesë e të anketuarve nga hulumtimi në terren e vendosin problemin edhe në kompetencën reale e cila u është ndarë gjykatave themelore me **Ligjin nga viti 2006, me ç'rast është rritur kompetenca e gjykatave me kompetencë të zgjeruar.** Ekzistojnë qëndrime se për lëndët më të vështira duhet të jenë kompetente edhe gjykatat më të larta të shkallës së parë, meqë në këtë mënyrë fitohet cilësi më e lartë e gjykimit.⁶⁴ Probleme plotësuese krijon edhe **koncentrimi i lëndëve që kanë të bëjnë me krimin e organizuar në Gjykatën Themelore Shkup 1** me çka lihet hapësirë për koncentrimin e fuqisë gjyqësore vetëm në një gjykatë dhe mundësi të rritura për presione dhe ndikime mbi gjyqtarët të cilët punojnë në Seksioni për krim të organizuar dhe korrupsion dhe shfaqja e dukurisë së konfliktit të interesave.⁶⁵ *Me themelimin e Gjykatës së Lartë Administrative, Gjykata Supreme de facto nuk mund ta ushtroj kompetencën e vet kushtetuese për të siguruar barazi gjatë aplikimit të ligjeve nga ana e gjykatave.*⁶⁶ Në mënyrë plotësuese është vënë në pikëpyetje edhe arsyeshmëria funksionale dhe institucionale e Gjykatës së Lartë Administrative duke e pasur parasysh faktin se vendos për 3% deri 4% të numrit të përgjithshëm të lëndëve administrative.⁶⁷

59 Qëndrimi i gjyqtarëve të fokus grupit në Shtip më datë 10.10.2018

60 Strategjia për reformë të sektorit të jurisprudencës 2017 – 2022 me Planin e Veprimit, f. 20.

61 Në përputhje me intervistat e realizuara dhe fokus grupet.

62 Qëndrimi i gjyqtarëve të fokus grupit në Shtip, Gostivar dhe Shkup.

63 Qëndrimet e gjyqtarëve të shprehura në fokus grupet në Shkup, Shtip dhe intervistë me gjykatës.

64 Intervista me ekspert juridik, 12.11.2018

65 Në përputhje me deklaratat nga fokus grupet në Shkup, Gostivar dhe intervistë me gjykatës.

66 Intervistë me ekspert juridik, 09.11.2018.


67 Intervistë me ekspert juridik, 12.11.2018.

Njëri nga objektivat e përcaktuara me *Strategjinë për reformë të sektorit të jurisprudencës për periudhën kohore të viteve 2017 – 2022*⁶⁸ është rishikimi i sistemit gjyqësor dhe i sistemit të prokurorisë publike nga aspekti i rrjetit dhe kompetencës së institucioneve, *ekipimit të tyre kadrovik dhe material*. Në Plan Veprimin e Strategjisë është parashikuar drejtimi strategjik për optimizimin e rrjetit gjyqësor me masë konkrete për hartimin e analizës për rrjetin gjyqësor dhe numrin e gjykatave në Republikën e Maqedonisë, me qëllim të optimizimit të numrit të gjykatave përmes amendimit të Ligjit për gjykata.⁶⁹ Në momentin e hartimit të kësaj analize, në Ministrinë e Drejtësisë hartohet analizë për optimizimin e rrjetit gjyqësor. Në përputhje me Planin 18 të Qeverisë së RM kjo analizë duhet të jetë gati përfundimisht në muajin dhjetor të vitit 2018.

Komisioni Evropian për efikasitetin e drejtësisë në “Sistemin gjyqësor evropian efikasiteti dhe kualiteti i drejtësisë” edicioni 2018, ofron një tabelë me pasqyrë të numrit të gjykatave të shkallës së parë si persona juridikë dhe numrin e të gjitha gjykatave si lokacione gjeografike në vitin 2016. Në përputhje me këtë tabelë, Republika e Maqedonisë është në kuadrin e mesatares së përcaktuar. E njëjta ka të bëjë edhe me tabelën që e pasqyron numrin e gjykatave të shkallës së parë me kompetencë të përgjithshme dhe numrin e gjykatave të specializuara të shkallës së parë në vitin 2016 me numra absolut dhe për 100 000 banorë.⁷⁰ Si gjykata me kompetencë të përgjithshme janë përfshirë të gjitha gjykatat, pavarësisht se a janë me kompetencë të përgjithshme ose të zgjeruar.

Sa i përket numrit të gjyqtarëve për 100 000 banorë, konform raportit të njëjtë⁷¹ Republika e Maqedonisë është mbi mesataren evropiane. Nëse bëjmë një krahasim rajonal, numër më të madh të gjyqtarëve kanë të gjitha shtetet e rajonit përveç Shqipërisë.⁷² Numri i gjyqtarëve është reduktuar nga viti 2014 deri në vitin 2017 (Grafiku 4).

Grafiku 4: Numri i gjyqtarëve aktivë dhe numri mesatar i gjyqtarëve nga viti 2014 deri në vitin 2017



68 Strategjia për reformë të sektorit të jurisprudencës për periudhën kohore 2017 – 2022, f. 6

69 Plan Veprimi është i aksesshëm në linkun në vijim:

<http://www.pravda.gov.mk/Upload/Documents/29.11.2017AkciskiPlannovo%20za%20veb.pdf>

70 Komisioni Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë, “Sistemi Gjyqësor Evropian Efikasiteti dhe Kualiteti i Drejtësisë, edicioni 2018, i aksesshëm në: <https://rm.coe.int/rapport-avec-couv-18-09-2018-en/16808def-9c#page=197&zoom=100,0,176>

71 Ibid.

72 Numër më të madh të gjyqtarëve kanë: Serbia, Mali i Zi, Bosnja e Hercegovina, Bullgaria, Sllovenia dhe Kroacia.

Nga fokus grupet rezulton se në të gjitha gjykatat mungojnë bashkëpunëtorë profesionistë. Sipas të dhënave statistikore të Komisionit Evropian për efikasitetin e drejtësisë, Republika e Maqedonisë është mbi mesataren evropiane sa i përket numrit të të punësuarve në gjykata të cilët nuk janë gjyqtarë.⁷³ Nga ana tjetër, shqetëson fakti se vetëm 14,5% e nëpunësve gjyqësorë janë bashkëpunëtorë profesionistë. Nuk ekzistojnë kriteret përkatëse për zgjedhjen dhe përgjegjësinë e administruesve gjyqësorë. Përveç kësaj, në mënyrë konsekuente nuk është zbatuar parimi i përfaqësimit të drejtë të pjesëtarëve të bashkësive në Republikën e Maqedonisë të cilat nuk janë shumicë, veçanërisht bashkësitë më të vogla.⁷⁴ Në Raportin e Këshillit Gjyqësor për vitin 2017⁷⁵ është konstatuar reduktimi i numrit edhe të shërbimit gjyqësor. Në vitin 2017 në pushtetin gjyqësor ishin të punësuar 2.278 nëpunës gjyqësorë. Të punësuarit në administratën gjyqësore kryejnë punë profesionale, administrative mbikëqyrëse, administrative teknike, ekzekutive dhe detyra tjera të punës për procedimin e lëndëve në punë në gjykata. Edhe pse gjatë vitit 2017 në gjykata u realizuan 77 punësime, gjendja e mungesës së kuadrit të nevojshëm përkatës në gjyqësor u konstatua në raportin e Këshillit Gjyqësor, që ka të bëjë me:

- kuadër udhëheqës i cili do t'i ndihmoj kryetarit të gjykatës, përkatësisht administruesit gjyqësor gjatë udhëheqjes me shërbimin gjyqësor dhe ushtrimin të punëve të administratës gjyqësore (administrues gjyqësor në disa gjykata, udhëheqës të shërbimit, udhëheqës të departamentit gjyqësor, udhëheqës të seksionit gjyqësor, udhëheqës të seksionit etj.).
- kuadër të nevojshëm profesional dhe administrativ – teknik i cili është në funksion të drejtpërdrejt të gjyqtarëve dhe realizimi i funksionit të tyre (bashkëpunëtorë gjyqësorë, daktilografë, udhëheqës të departamenteve, përkthyes, persona të cilët e bëjnë dërgesën, të punësuar në sekretari dhe ngjashëm).
- Kuadro profesional nga fusha e administrimit me resurse njerëzore, revizionit të brendshëm, kontrolli i brendshëm publik financiar, planifikimi strategjik dhe ngjashëm. Përkatësisht kuadro të cilët nuk janë në korrelacion të drejtpërdrejt me funksionin e gjyqtarit, por rrjedhat bashkëkohore të funksionimit të institucioneve këtë e determinojnë si nevojë.

Sa i përket bashkëpunimit me burgjet në Republikën e Maqedonisë, problemi më i madh paraqitet kur duhet të transportohet personi i akuzuar në gjykim, i cili për momentin e vuan dënimin me burgim. Mjetet financiare të nevojshme për transport më së shpeshti theksohen si shkak për gjendjen e këtyllë.⁷⁶ Në mënyrë plotësuuese, në shtetin tonë nuk shfrytëzohen sa duhet mënyrat alternative të zgjidhjes së kontesteve, veçanërisht ndërmjetësimi.⁷⁷

73 Burimi: Komisioni Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë, CEPEJ-STAT, <https://www.coe.int/en/web/cepej/dynamic-database-of-european-judicial-systems>

74 Ibid.

75 Raport për punën e Këshillit Gjyqësor për vitin 2017, i aksesshëm në: http://sud.mk/wps/wcm/connect/ssrm/e997d2b6-409e-428d-8eb3-92f0ca31b2c3/IZVESTAJ+ZA+RABOTATA+NA+SSRM+2017.pdf?MOD=AJPERES&CACHEID=ROOTWORKSPACE.Z18_L8CC1J41L0B520APQFKICD0CR4-e997d2b6-409e-428d-8eb3-92f0ca31b2c3-kZvrQCW

76 Qëndrimi i gjyqtarit dhe ekspertit juridik të prezantuar në ngjarjen Koalicioni "Të Gjithë për Gjykim të Drejtë" më datë 05.12.2018.


77 Strategjia për reformë të sektorit të jurisprudencës për periudhën kohore 2017 – 2022, e aksesshme në: <http://www.pravda.gov.mk/resursi/12>

2.3 Opsione në lidhje me strukturën organizative të rrjetit të sistemit gjyqësor dhe ndikimi i tyre

2.3.1 Opsioni – Struktura e pandryshuar organizative e sistemit gjyqësor dhe kompetencave të gjykatave

Në përputhje me të dhënat statistikore, të elaboruara më lartë, dhe konform hulumtimit të realizuar në terren në lidhje me gjendjen statusquo, përkatësisht struktura e njëjtë organizative, nuk do të kontribuoj në përmirësimin e efikasitetit të sistemit të jurisprudencës, dhe njëkohësisht në avancimin e kualitetit të drejtësisë. Nga ana tjetër, me këtë zgjidhje nuk optimizohen dhe racionalizohen shpenzimet edhe të gjykatave (gjykatave të vogla) edhe të qytetarëve si shfrytëzues të fundit.⁷⁸

Me këtë zgjidhje nuk mbahet llogari për qasjen deri te gjykata si element kryesor i qasjes deri te drejtësia, me vet faktin se kompetencën reale të gjykatave me kompetencë të zgjeruar, e cila është përcaktuar në Ligjin për gjykata, e posedojnë vetëm një numër i caktuar i gjykatave.⁷⁹ Duhet të shqyrtohen edhe të ardhurat e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë.⁸⁰



Gjykatave me kompetencë të zgjeruar iu rrit kompetenca reale⁸¹ për lëndë të caktuara të cilat deri atëherë ishin në kompetencë të të gjitha gjykatave themelore. Me këtë, një numër i madh i lëndëve, në mesin e të cilave edhe lëndët për të cilat është përcaktuar dënim me burgim mbi 5 vjet⁸² dhe lëndë në të cilat fëmijët janë në konflikt me ligjin janë në kompetencë të gjykatave me kompetencë të zgjeruar, për dallim nga zgjidhja e vitit 1995. ***Kjo zgjidhje i rrit shpenzimet jo vetëm për të akuzuarit por edhe për dëshmitarët dhe për të dëmtuarit, prindërit e fëmijëve në konflikt me ligjin dhe qendrat për punë sociale.***

78 Qëndrim të këtyllë kishin të gjithë pjesëmarrësit në fokus grupet në Shkup, Gostivar dhe Shtip, si dhe intervistat me gjykatës dhe ekspertë juridikë.

79 Qëndrim të këtyllë kishin të gjithë gjyqtarët dhe të anketuarit nga të gjitha fokus grupet si dhe nga intervistat me gjyqtarë më datë 12.11.2018 dhe ekspertë juridikë 13.11.2018

80 Intervistë me gjykatës data 22.10.2018.

81 Kompetenca reale u rrit me Ligjin për gjykata nga viti 2006.

82 Me Ligjin nga viti 1995 vetëm disa gjykata të caktuara kishin kompetencë reale për vepra për të cilat është përcaktuar dënim me burgim mbi 10 vjet burg. Zgjidhja e tanishme e gjykatave me kompetencë të zgjeruar janë me kompetencë reale për vepra për të cilat është përcaktuar dënim me burgim mbi 5 vjet.

Zgjidhjet sa u përket gjykatave me kompetencë të zgjeruar nuk e kanë parasysh distancën e komunave të caktuara në RM me gjykatën përkatëse me kompetencë të zgjeruar.⁸³

Në gjykatat më të vogla dhe në gjykatat në të cilën kanë numër më të vogël të gjyqtarëve paraqitet problemi edhe sa u përket procedurave procesuale, veçanërisht në lidhje me procedurën penale ku problem paraqet formimi i Kolegjit Penal në përputhje me nenin 25, paragrafi 5 të Ligjit për procedurë penale. Për shkak të mospasjes së numrit të mjaftueshëm të gjyqtarëve në gjykata të caktuara ndodh që disa nga gjykatat themelore të parashtrojnë kërkesë deri te Gjykata e Apelit në juridiksionin në të cilin vepron Gjykata Themelore për delegim të gjyqtarit për formimin e Kolegjit Penal. Së këtejmi, u theksua se në këto kolegje ndonjëherë marrin pjesë edhe gjyqtarë qytetarë për shkak të mungesës së numrit të mjaftueshëm të gjyqtarëve në gjykatën përkatëse. Sipas gjyqtarëve, në interes të efikasitetit të procedurës, ndërsa ndonjëherë duke i marrë parasysh rrethanat e rastit konkret, është me rëndësi që ky Kolegj të formohet më shpejtë pa u pritur delegimi i gjyqtarëve.⁸⁴

Kompetenca reale dhe territoriale në lidhje me fëmijët duhet të perceptohet nga aspekti i interesit më të mirë të fëmijës. Kështu që, një pjesë e lëndëve në të cilat palë në procedurat janë fëmijë, është më së miri por edhe në interes të tyre të gjykohej në gjykatat që janë më afër tyre. Në përputhje me strukturën aktuale organizative, veprat e këtilla janë në kompetencë të departamenteve të specializuara gjyqësore në gjykatat me kompetencë të zgjeruar.⁸⁵

Ekzistimi vetëm i një seksioni për krim të organizuar me kompetencë reale për gjithë territorin e RM në mënyrë plotësuese do ta vë në pikëpyetje pavarësinë e gjyqtarëve në këtë seksion, për shkak të koncentrimit të fuqisë gjyqësore në një gjykatë. Numrat flasin në drejtim të asaj se Gjykata Themelore Shkup 1 është gjykata më e ngarkuar me punë, përkatësisht ka numër më të madh të përgjithshëm të lëndëve në punë. Në krahasim me gjykatat e tjera themelore, kohëzgjatja e lëndëve sipas ditëve në Gjykatën Themelore Shkup 1 është më e gjatë. Një pjesë e të anketuarve janë të mendimit se zgjidhja e këtillë në mënyrë plotësuese e ngarkon edhe Gjykatën e Apelit në Shkup, e cila ka numrin më të madh të lëndëve në punë në krahasim me gjykatat e tjera të apelit, dhe kohëzgjatje më të gjatë mesatare të lëndëve sipas ditëve.⁸⁶ Problem paraqet edhe ajo që një numër i madh i veprave penale kaluan në kompetencë reale të seksionit për krim të organizuar.⁸⁷ Sipas gjyqtarëve ata janë të mendimit se edhe gjykatat e tjera me kompetencë të zgjeruar mund të gjykojnë lëndë që janë në kompetencë të seksionit për krim të organizuar.⁸⁸ Në afat të gjatë kohor, zgjidhja e këtillë mund të kontribuoj në humbjen e kapaciteteve dhe kushteve për gjykim në gjykata të caktuara të cilat paraprakisht kanë gjykuar dhe kanë pasur kushte për gjykimin e veprave të këtilla.⁸⁹

83 Qëndrimi i gjyqtarëve në fokus grupet Shkup, Shtip, Gostivar dhe Manastir.

84 Qëndrimi i gjyqtarëve nga fokus grupet në Shtip më datë 10.10.2018.

85 Qëndrimi i gjyqtarëve nga fokus grupi në Shtip, dhe intervista me gjyqtarin më datë 12.11.2018.

86 Qëndrimin e këtillë e kanë një pjesë e gjyqtarëve

87 Me ndryshimet e Ligjit për gjykata nga viti 2008 u zgjerua kompetenca reale e Seksionit të specializuar gjyqësor për krim të organizuar në Gjykatën Themelore në Shkup.

88 Konkretisht u përcaktuan veprat: prodhim i paautorizuar dhe lëshim në qarkullim i drogave narkotike, substancave psikotrope dhe prekursorëve nga neni 215 paragrafi 2, pastrim parash dhe të përfitime të tjera nga veprat penale me vlerë të konsiderueshme nga neni 273; vepra penale kontrabandim të migrantëve nga neni 418-b nga Kodi Penal.

89 Qëndrim i gjyqtarit nga fokus grupi në Shkup më datë 15.10.2018 dhe qëndrimi i gjyqtarit në fokus grupin Gostivar më datë 22.10.2018.

Me themelimin e Gjykatës së Lartë Administrative, Gjykata Supreme de facto nuk mund ta ushtroj kompetencën e saj kushtetuese për sigurimin e unitetit gjatë aplikimit të ligjeve nga ana e gjyqtarëve.⁹⁰ Është vënë në pikëpyetje edhe arsyeshmëria funksionale dhe institucionale e Gjykatës së Lartë Administrative duke e pasur parasysh faktin se vendos për 3% deri 4% të numrit të përgjithshëm të lëndëve administrative.⁹¹ Nga ana tjetër, Gjykata Administrative mund të ballafaqohet me problemin e ri të zgjidhjeve të propozuara në lidhje me mbledhjet publike, me ç'rast diskutimi publik është parashikuar si rregull dhe jo si përjashtim.⁹² Problemi mund të paraqitet nëse ndonjë qytetar, nga ndonjë komunë tjetër në RM, duhet të vijë në Shkup, me ç'rast i kufizohet e drejta e qasjes deri te gjykata.⁹³

Gjykatat ballafaqohen me problemin e mungesës së bashkëpunëtorëve profesionistë.⁹⁴ Përveç kësaj, u theksua se nevojitet ekipimi shtesë dhe pajisje më të mirë TIK nëpër gjykata. Një pjesë e gjykatave kanë mungesë të daktilografëve, specialistë të IK, kontabilistë, ndërsa nuk kanë leje për punësim nga Ministria e Financave,⁹⁵ e që në mënyrë plotësuese është element rëndues duke u nisur nga fakti se nuk respektohet dispozita ligjore për akordimin e 0,8 % nga BPV për gjykatat si kusht për buxhet të pavarur gjyqësor. Nevojitet përforcimi i shërbimit gjyqësor të gjykatave, trajnime të shërbimit profesional, si dhe persona të trajnuar të cilët e bëjnë dërgesën.

2.3.2 Opsioni: Struktura e re organizative e sistemit gjyqësor dhe kompetenca të reja të gjykatave

- Një pjesë e gjykatave më të vogla të cilat nuk kanë lëndë të mjaftueshme në punë dhe kanë numër të vogël të gjyqtarëve të bëhen seksione të gjykatave më të mëdha dhe të gjykatave me strukturë të mirë të lokacionit; Nevojitet që në ato seksione të ekzistoj arkiv dhe seksione pranimi në mënyrë që qytetarët të mund ta realizojnë aty të drejtën e tyre. Me një kalendar të mirë të kryetarit të gjykatës mund të dërgohen gjyqtarë të gjykojnë në këto seksione. Në këtë mënyrë do të arrihet ekonomizim për qytetarët por edhe për buxhetin gjyqësor.

- Tri gjykatat me kompetencë themelore, përkatësisht Gjykata Themelore në Kërçovë, Gjykata Themelore në Gjevgjeli dhe Gjykata Themelore në Kavadar, të cilat dallojnë për nga prurja e lëndëve dhe numrit të përgjithshëm të lëndëve në punë, për dallim nga gjykatat e tjera me kompetencë themelore, nevojitet të jenë gjykata me kompetencë të njëjtë reale si edhe gjykatat me kompetencë të zgjeruar.⁹⁶ Në këto gjykata ka numër më të madh të gjyqtarëve në krahasim me disa gjykata me kompetencë të zgjeruar.

90 Intervistë me ekspert juridik, 09.11.2018.

91 Intervistë me ekspert juridik, 12.11.2018

92 Ky zgjidhje u publikua në ENER.

93 Intervistë me ekspert juridik, 12.11.2018.

94 Ky qëndrim u prezantua ngatë gjithë gjyqtarët e fokus grupeve.

95 Ky qëndrim u prezantua nga gjyqtarë të fokus grupeve.

96 Kompetenca e zgjeruar i këtyre gjyqtarëve është dhënë me propozim ndryshimet të cilat janë miratuar nga Qeveria në mbledhjen e 108 më datë 12.12.2018, të cilat në dhjetor të vitit 2018 janë në procedurë kuvendore.

- Një pjesë e gjykatave themelore, të cilat kanë strukturë të mirë gjeografike dhe numër jo aq të vogël të lëndëve, do të duhej të kenë kompetencë të rritur reale, megjithatë jo kompetencë të njëjtë reale si të gjykatave të tjera të cilat kanë kompetencë të zgjeruar. Ky rekomandim duhet të shqyrtohet përkundrejt mundësisë që të vijë deri në bashkimin e dy gjykatave më të vogla, me atë që në njërin nga komunat do të ekzistojnë seksione kështu që gjykata do të kishte lëndë në punë dhe numër të mjaftueshëm të gjyqtarëve që të ketë kompetencë si gjykatë me kompetencë të zgjeruar.
- Veprat e krimit të organizuar të gjykohen në më shumë qendra, jo vetëm në seksionin për krim dhe korrupsion të organizuar në Gjykatën Themelore Shkup 1;
- Revidim të kompetencës reale të seksioneve për krim të organizuar me ç'rast veprat të cilat tani janë në kompetencë të seksionit për krim të organizuar të jenë në kompetencë edhe të gjykatave të tjera themelore;
- Ndryshime në strukturën organizative të gjyqësisë administrative për çka nevojitet analizë dhe debat plotësues, duke i pasur parasysh qëndrimet e ndryshme aktuale.

Konform të dhënave statistikore dhe hulumtimit të realizuar në terren, si nevojë u imponua opsioni për strukturë të re të rrjetit me qëllim që të kemi sistem efikas gjyqësor dhe të rritet cilësia e drejtësisë.

*Me strukturë të re të rrjetit do të arrihej dispersioni i fuqisë gjyqësore, e që nga ana tjetër do të rezultojë me parandalimin e konfliktit të interesit. Me strukturën e re të rrjetit do të optimizohen dhe racionalizohen shpenzimet edhe të gjykatave edhe të palëve.⁹⁷ Konsolidimi i gjykatave, me atë që një pjesë e gjykatave do të shndërrohen në seksione, do të kontribuoj edhe në fuqizimin e gjykatave përkatëse me kuadër, veçanërisht me gjyqtarë dhe bashkëpunëtorë profesionistë të cilët për momentin mungojnë në gjykata. Konsolidimi i këtillë i gjykatave do të kontribuoj edhe në drejtimin e specializimeve më të mira të gjyqtarëve (edhe përmes themelimit të seksioneve të specializuara gjyqësore në të gjitha gjykatat themelore), si dhe në drejtim të kryerjes më të mirë të shërbimeve të gjyqësore. **Më e rëndësishmja është ajo se me strukturën e re organizative dhe me kompetencën e re reale do të përmirësohet qasja e qytetarëve deri te gjykatat.***

Një numër i vogël i gjykatave të cilat kanë numër të vogël të lëndëve në punë duhet të shndërrohen në seksione të gjykatave më të afërta të mëdha ose të gjykatave me strukturë të mirë gjeografike.⁹⁸ Me qëllim që qytetarët t'i realizojnë të drejtat e tyre edhe në seksionet e gjykatave më të mëdha, propozimet ishin në drejtim se **nevojitet edhe në ato seksione të ekzistoj arkiv dhe seksione pranimi që qytetarët të mund ta realizojë aty të drejtën e tyre.**⁹⁹ Sa i përket gjykimit të lëndëve u apostrofua shembulli me seksionin e Gjykatës Themelore në Gjevgjeli në Vallandovë i cili aktualisht funksionon. Në këtë seksion ka gjyqtarë për kundërvajtje, dhe me një kalendar të mirë të kryetarit të gjykatës mund të dërgohen

97 Qëndrimi i gjyqtarëve nga fokus grupet në Shtip, Gostivar, Shkup dhe intervista me gjykatës më datë 22.10.2018 dhe më datë 12.11.2018

98 Këtë qëndrim e mbajnë shumica e të anketuarve.

99 Propozim i gjyqtarëve nga fokus grupi në Shtip dhe fokus grupi në Shkup

gjyqtarë të gjykojnë edhe lëndë të tjera.¹⁰⁰ U theksua se me dërgimin e gjyqtarëve në seksione, sipas nevojës, në ditë të caktuara për gjykim **do të arrihet ekonomizim për qytetarët edhe për buxhetin gjyqësor.**

Së këtejmi, në këtë mënyrë do të fuqizohen gjykatat nga aspekti ekipor, si dhe do të përmirësohet cilësia e gjykimit.¹⁰¹ **Do të evitohen edhe pengesat të cilat paraqiten edhe sa u përket ligjeve procesuale,** siç është themelimi i Kolegjit Penal konform nenit 25 të Ligjit për procedurë penale.¹⁰² Sipas kësaj mënyre do të përmirësohet edhe qasja e qytetarëve deri te gjykatat duke e pasur parasysh faktin se brenda seksionit mund t'i realizojnë të drejtat e tyre, përfshirë këtu edhe efektuimin e plotë të mundësisë së realizimit të gjykimit në seksionet për gjykim konform nenit 23 paragrafit 4 të Ligjit për gjykata.

Me më pak gjykata në një juridiksion të apelit do të kontribuohet në unifikimin e praktikës gjyqësore, ndërsa me këtë do të rritet besimi ndaj gjyqësorit. Me këtë zgjidhje do të shfrytëzohet edhe kapaciteti i gjyqtarëve nga gjykatat më të vogla në gjykatat më të mëdha, meqë ato do të kenë më shumë lëndë dhe më komplekse për punë, ndërsa nga ana tjetër edhe shansi do të jetë i barabartë edhe për gjyqtarët të cilët tani janë në gjykatë më të vogël ose më të madhe meqë do të kenë prurje të barabartë të lëndëve dhe do të veprojnë ndaj një numri të barabartë të lëndëve dhe e gjithë kjo ndikon në notimin e gjyqtarëve.¹⁰³

Nëse shkohet në drejtim të barazimit të kompetencës reale të të gjitha gjykatave themelore, në një pjesë të gjykatave më të vogla do të mungoj kuadri i gjyqtarëve që të veprojnë ndaj lëndëve meqë një pjesë e gjykatave me kompetencë themelore nuk kanë kuadër të këtillë gjyqësor.¹⁰⁴

Mes tjerash, u rekomandua se një pjesë e gjykatave themelore, të cilat kanë strukturë të mirë geografike dhe numër jo aq të vogël të lëndëve, do të duhej të kenë kompetencë të rritur reale, mirëpo jo kompetencë të njëjtë reale si të gjykatave të tjera të cilat kanë kompetencë të zgjeruar.¹⁰⁵ Ky rekomandim duhet të shqyrtohet përkundrejt mundësisë që të vijë deri në bashkimin e dy gjykatave më të vogla, me ç'rast në njërin nga komunat do të ekzistonin seksione, kështu që gjykata do të kishte lëndë në punë dhe numër të mjaftueshëm të gjyqtarëve që të ketë kompetencë si gjykatë me kompetencë të zgjeruar.

Gjykatave me kompetencë themelore të cilat kanë prurje më të mëdha dhe numër më të madh të përgjithshëm të lëndëve në punë, si dhe numër të mjaftueshëm të gjyqtarëve, duhet t'u kthehet kompetenca reale dhe të kenë

100 Qëndrimi i gjyqtarëve të fokus grupit në Shtip më datë (10.10.2018) dhe Fokus grupit në Shkup (15.10.2018).


101 Qëndrimi i prezantuar nga gjyqtari i fokus grupit në Shtip më datë 10.11.2018.

102 Qëndrimi i prezantuar nga gjyqtari i fokus grupit në Shtip më datë 10.11.2018.

103 Qëndrimi i prezantuar nga gjyqtari i fokus grupit në Shtip më datë 10.11.2018. Sa i përket mundësisë më të mirë dhe më të drejtë për notim, ishin opinionet e të gjithë gjyqtarëve të fokus grupeve.

104 Në përputhje me deklaratat e një pjese të pjesëmarrësve nga fokus grupin në Shtip nëse kompetenca reale barazohet, përkatësisht nëse zgjerohet kompetenca edhe e gjykatave themelore me kompetencë themelore atëherë do të mungoj kuadri i gjyqtarëve sepse lëndët duhet t'i procedojnë edhe gjyqtari për vlerësimin e aktakuzës, këshillit, si dhe gjyqtar të falimentimit.

105 Si shembull në fokus grupet në Shtip dhe në Shkup u vu në pah kompetenca reale e përcaktuar me Ligjin e vitit 1995 për një pjesë të gjykatave me kompetencë themelore.



kompetencë të njëjtë reale si të gjykatave me kompetencë të zgjeruar.¹⁰⁶ Me riorganizimin e këtillë do të mundësohet themelimi i departamenteve të specializuara gjyqësore për delikuecën e fëmijëve në të gjitha gjykatat themelore. Veç tjerash, në gjykata kuadri do të plotësohet në mënyrë përkatëse e që për momentin është në deficit në disa gjykata themelore. Zgjidhja e këtillë do të ketë implikime edhe mbi administratën e cila aktualisht punon në gjykatat më të vogla, megjithatë, në përputhje me Ligjin për shërbimin gjyqësor,¹⁰⁷ me vendim të kryetarit, meqë në atë rast do të ketë një kryetar, ata mund të sistematizohen në seksione ose në gjykatë.

Gjatë vendosjes për riorganizimin e rrjetit gjyqësor duhet të mbahet llogari edhe për afërsinë e gjykatave të cilat do të bëheshin seksione, si dhe pozita gjeografike e gjykatave dhe qarkullimi i njerëzve dhe mallrave në zonën konkrete.¹⁰⁸

Veprat e krimit të organizuar duhet të gjykojnë në më shumë qendra, jo vetëm në Seksionin për krim të organizuar dhe korrupsion në Gjykatën Themelore Shkup 1 me kompetencë reale për gjithë territorin e RM.¹⁰⁹ Me koncentrimin e fuqisë gjyqësore shumë lehtë ndikohet në veprimin dhe miratimin e vendimeve gjyqësore. Në këtë mënyrë do të fuqizohet pavarësia edhe sa i përket ndikimit të gjyqësorit nga ana e elitës gjyqësore.¹¹⁰ **Kur do të kemi dispersion në më shumë gjykata, ndikimi do të ishte më i vogël, ndërsa do të arrihej efikasitet më i madh dhe azhurnim sa i përket veprimit ndaj këtyre lëndëve.** Me zgjidhjen e këtillë, në mënyrë plotësuese do të shkarkohet puna e Gjykatës Themelore Shkup 1 e cila sipas statistikave ka numër më të madh të lëndëve në krahasim me gjykatat e tjera themelore, numër më të madh të lëndëve në total në punë në krahasim me të gjitha gjykatat në RM.¹¹¹ **Seksione të specializuara për krim të organizuar në më shumë qendra do të kontribuojnë për efikasitet më të madh gjatë procedimit të këtyre veprave dhe cilësi më të lartë të vet procedurave.** Zgjidhja e këtillë do të kishte implikime financiare për sigurimin e kushteve në gjykata ku do të themelohen seksionet e specializuara gjyqësore të cilat do të veprojnë ndaj atyre veprave. Megjithatë, tanimë një pjesë e gjykatave kanë përvojë sa i përket veprimit ndaj lëndëve të kësaj natyre.¹¹²

Sa i përket kompetencës reale të seksioneve për krim të organizuar, nëse janë më shumë seksione, duhet të jetë më e ulët në krahasim me zgjidhjen aktuale dhe kompetencën reale e cila i është deleguar seksionit të specializuar gjyqësor me ndryshimet e Ligjit nga viti 2008. Një pjesë e kompetencës reale e cila korrespondon me zgjidhjen ekzistuese në kompetencë të seksionit të specializuar gjyqësor për krim të organizuar duhet të kalojë në kompetencë të gjykatave me kompetencë të zgjeruar. Konkretisht, në kompetencë të të gjitha gjykatave me

106 Këtu u potencua Gjykata Themelore në Gjevgjeli si gjykatë kufitare, Gjykata Themelore në Kavadar dhe Gjykata Themelore në Kërçovë.

107 Neni 47 i Ligjit për shërbim gjyqësor, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 43/2014, 33/2015, 98/2015, 6/2016 dhe 198/2018.

108 Intervistë me ekspert juridik më datë 09.11.2018 dhe qëndrim i gjyqararit i deklaruar në fokus grupin në Shkup më datë 15.10.2018

109 Qëndrim të këtillë patën të gjithë të anketuarit.

110 Intervistë me ekspert juridik 09.11.2018 dhe me gjyqtar më datë 12.11.2018

111 Intervistë me gjyqtar më datë 12.11.2018 dhe qëndrime të gjyqtarëve të fokus grupit në Shtip, Shkup dhe Gostivar.

112 Si shembuj u vu në dukje Gjykata Themelore Gjevgjeli dhe Gjykata Themelore Gostivar deri në vitin 2006.

kompetencë të zgjeruar duhet të kalojnë veprat prodhim i paautorizuar dhe lëshim në qarkullim të drogave narkotike, substancave psikotrope dhe prekursorëve nga neni 215 paragrafi 2; pastrim parash dhe dobi tjera nga vepra penale me vlerë të konsiderueshme nga neni 273; vepra penale kontrabandim të migrantëve nga neni 418-b të Kodit Penal.¹¹³

Ekzistojnë edhe qëndrime se veprat më të rënda duhet t'i jepen në kompetencë gjykatave më të larta, përkatësisht gjykatave të apelit në mënyrë që të përmirësohet cilësia e gjykimit, por vetëm për një numër të kufizuar të veprave penale.¹¹⁴

Sa i përket gjyqësisë administrative mendimet janë të ndara. Një pjesë e të anketuarve janë të mendimit se Gjykata e Lartë Administrative nuk duhet të ekzistoj, përkatësisht kjo kompetencë përsëri t'i kthehet Gjykatës Supreme.¹¹⁵ Në këtë mënyrë Gjykata Supreme do ta realizonte kompetencën e vet në sigurimin e aplikimit unik të ligjeve, megjithatë, kjo zgjidhje do të kishte implikime edhe në punën e Gjykatës Supreme. Nga ana tjetër, këtu paraqitet problemi i gjyqtarëve të cilët tanimë janë zgjedhur në Gjykatën e Lartë Administrative. Një pjesë e të anketuarve janë të mendimit se nevojiten 2 sisteme paralele, përkatësisht gjyqësi e rregullt dhe gjyqësi administrative.¹¹⁶

Sa i përket ekipimit të gjykatave me strukturën e re organizative do të kishte implikime financiare sa i përket ekipimit kadrovik dhe teknik, si dhe shpenzimet e rrugës për udhëtimin e gjyqtarëve. Megjithatë, duke e pasur parasysh faktin se edhe struktura e këtyllë organizative e sistemit gjyqësor në mënyrë plotësuese ballafaqohet me problemin e ekipimit kadrovik dhe teknik, riorganizimi në afat të gjatë megjithatë është zgjidhje më e mirë.

113 Qëndrim i gjyqtarëve nga fokus grupi Gostivar (22.10.2018) dhe fokus grupi në Shkup (15.10.2018).

114 Intervistë me ekspert juridik më datë 12.11.2018

115 Këtë qëndrim mban një pjesë e të anketuarve nga fokus grupet, si dhe ekspertët juridikë me të cilët është realizuar intervista.

116 Intervistë me ekspert juridik 09.11.2018

3. GJYQTARË DHE GJYQTARË - POROTË

3.1 Analiza e standardeve dhe rekomandimeve ndërkombëtare

Komisioni i Venecias në pasqyrën e vet sistematike të standardeve evropiane për pavarësi gjyqësore, konstaton se vendimet në lidhje me caktimin/avancimin dhe notimin e gjyqtarëve duhet të miratohen në bazë të meritave, duke i pasur parasysh kualifikimet, integritetin, aftësinë dhe efikasitetin e gjyqtarëve.¹¹⁷ Më datë 22 tetor të vitit 2018 Komisioni i Venecias e publikoi opinionin në lidhje me Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Këshillin Gjyqësor dhe Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për gjykata.¹¹⁸ Opinioni i referohet ndryshimeve të fundit ligjore nga muaji maj i vitit 2018 dhe përfshin tri tema kryesore: parimet e përgjegjësisë disiplinore të gjyqtarëve, procedurat dhe trupat disiplinorë dhe notimi i gjyqtarëve. Sa i përket sistemit të rekrutimit të gjyqtarëve, Komisioni i Venecias autoriteteve maqedonase u sugjeron t'i referohen opinioneve të saj paraprake dhe standardeve relevante evropiane. Në opinionin e Komisionit të Venecias për projekt ndryshimet e Ligjit për gjykata, si dhe për të drejtat dhe detyrimet e gjyqtarëve dhe të Këshillit Gjyqësor të Malit të Zi, Komisioni i Venecias theksoi se nevojiten dispozita për caktimin e gjyqtarëve me karrierë të mbyllur gjyqësore me kërkesa rreptësisht të përcaktuara për përvojën gjyqësore, pozitat e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme janë përjashtimi i vetëm.¹¹⁹ Në përbërjen e Gjykatës Supreme dhe të Gjykatës Kushtetuese duhet të ketë gjyqtarë me ekspertizë të veçantë në fushën e të drejtave të njeriut.¹²⁰ Në një numër të madh të vendeve gjyqtarët caktohen në bazë të rezultateve nga provimi, ndërsa në vende tjera përzgjidhen nga praktikantët me përvojë. *A priori* të dy kategoritë e zgjedhjes mund

117 [http://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-JD\(2008\)002-e](http://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-JD(2008)002-e)

118 Komisioni i Venecias, opinion për Ligjin për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për Këshillin Gjyqësor dhe Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për gjykata 22 tetor 2018, i aksesshëm në: [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2018\)022-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2018)022-e)

119 Opinioni i Komisionit të Venecias për projekt ndryshimet e Ligjit për gjykata dhe për të drejtat dhe obligimet e gjyqtarëve dhe të Këshillit Gjyqësor të Malit të Zi, i aksesshëm në: [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2014\)038-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2014)038-e)

120 Si trupa në të cilët përcaktohet praktika gjyqësore. Opinioni për Bosnjë e Hercegovinën është i aksesshëm në linkun në vijim: [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL\(1999\)078-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL(1999)078-e)

të iniciojnë pyetje të ndryshme. Është diskutabile se a duhet provimi të jetë baza e vetme për zgjedhje ose duhet t'u përkushtohet vëmendje kualitative personale dhe përvojës së kandidatit. Sa i përket përzgjedhjes së gjyqtarëve nga radhët e praktikentëve me përvojë, kjo mund të shkaktoj pasiguri sa i përket objektivitetit të procedurës së zgjedhjes.¹²¹

Në lidhje me kontekstin maqedonas, Komisioni Evropian¹²² konstatoi se shteti duhet ta depolitizoj sistemin gjyqësor për caktimin dhe avancimin në praktikë, dhe jo vetëm në ligj, duke vlerësuar se vendimet për caktimin dhe avancimin e gjyqtarëve në gjykatat themelore është gjithnjë e më e qartë se bazohen në merita, megjithatë vendimet për caktimin dhe avancimin e kryetarëve të gjykatave dhe të gjyqtarëve në gjykata më të larta edhe më tutje i nënshtrohen marrëveshjeve politike. Nga ana tjetër, Komisioni Evropian në Prioritetet e tij Urgjente të Reformave (PUR)¹²³ e konstatoi nevojën e procesit të depolitizimit të caktimit dhe avancimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë që duhet të zbatohet në aspektin praktik dhe jo vetëm në atë teorik.

Sa i përket cilësisë së drejtësisë, vlerësimi i Komisionit Evropian¹²⁴ konsiston me atë se mënyra e organizimit të sistemit gjyqësor dhe struktura e karrierës së gjyqtarëve, i çon vetëm në miratimin formal të vendimeve në mënyrë që të arrihen qëllime afatshkurtra të produktivitetit, në vend të zgjidhjes së mirëfilltë të kontesteve, ndërtimit të praktikës së qëndrueshme gjyqësore, miratimit të aktgjyqimeve të qarta të justifikuara mirë dhe sigurimit të sigurisë afatgjatë juridike në interes të qytetarëve. Kjo aludon në faktin se procedura vjetore e notimit të gjyqtarëve duhet të revidohet meqë ka efekt të dëmshëm mbi cilësinë e drejtësisë. Sistemi i këtillë theksin e vë vetëm mbi produktivitetin e gjyqtarëve dhe jo mbi cilësinë e punës së tyre, mbi kompetencën dhe shërbimet që ua japin qytetarëve.

Zgjedhja e kuadrove të gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë ekskluzivisht vetëm nga Akademia për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë ishte rekomandimi i vetëm që u plotësua në pjesën e jurisprudencës nga Raporti i parë i Grupit të Ekspertëve i udhëhequr nga Pribe. Në Raportin e dytë të Grupit të Ekspertëve theksohet respektimi konsekuent i këtij rekomandimi.¹²⁵

Komisioni Evropian në Prioritetet Urgjente të Reformave (PUR) e konstatoi nevojën e vendosjes së sistemit sipas punës/realizimit, i cili do të bazohet mbi standardet kualitative dhe kuantitative e që do të shërbej si bazë për avancimin në karrierë të gjyqtarëve.¹²⁶

121 Opinioni i Komisionit të Venecias për emërimet gjyqtarëve, 2007, i aksesshëm në: [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2007\)028-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2007)028-e)


122 https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2015/20151110_report_the_former_yugoslav_republic_of_macedonia.pdf

123 https://eeas.europa.eu/sites/eeas/files/urgent_reform_priorities_mk.pdf

124 https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2013/package_brochures/the_former_yugoslav_republic_of_macedonia_2013.pdf

125 Grupi i Lartë i Ekspertëve për çështje sistemore në lidhje me sundimin e së drejtës, Vlerësimi dhe rekomandimi i Grupit të Lartë të Ekspertëve për çështje sistemore në lidhje me sundimin e së drejtës, viti 2017, i aksesshëm në: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/2017.09.14_seg_report_on_systemic_rol_issues_for_publication.pdf

126 https://eeas.europa.eu/sites/eeas/files/urgent_reform_priorities_mk.pdf



Sa u përket gjyqtarëve-porotë, në Raportin e fundit të vitit 2018, GREKO rekomandon të ndërmerren masa përkatëse në drejtim të fuqizimit të pavarësisë, paanshmërisë dhe integritetit të gjyqtarëve-porotë, mes tjerash, përmes inkorporimit të udhëzimeve dhe trajnimeve specifike për çështje të etikës, sjellje të prishme, parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave dhe çështje tjera të lidhura.¹²⁷

3.2 Gjendjet në Republikën e Maqedonisë në lidhje me gjyqtarët dhe gjyqtarët-porotë

Në kapitullin 3 të Ligjit për gjykata janë rregulluar çështjet e zgjedhjes së gjyqtarëve dhe gjyqtarëve-porotë, specializimi i gjyqtarëve, sistematizimi nga një departament në departamentin tjetër, si dhe transferimi i përkohshëm i gjyqtarëve në gjykatë tjetër, sistematizimi i gjyqtarëve në rast të suspendimit ose riorganizimit të gjykatës.¹²⁸

Standardet në pjesën hyrëse të këtij kapitulli kryesisht janë harmonizuar me standardet e BE-së për pavarësinë e gjyqësorit. Bëhet fjalë për mandatin e përhershëm të gjyqtarëve dhe dispozita me të cilën parashikohet se gjyqtari nuk mund të transferohet nga njëra në gjykatën tjetër kundër vullnetit të tij. Megjithatë, është parashikuar se gjyqtari, me përjashtim mund të sistematizohet në një departament tjetër gjyqësor kundër vullnetit të tij me një vendim të arsyetuar me shkrim të kryetarit të gjykatës dhe sipas mendimit paraprakisht të siguar nga mbledhja e përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë, ku një gjë të këtitillë e kërkon vëllimi i rritur dhe lënda në punë të gjykatës, por më së shumti për një kohë njëvjeçare. Gjithashtu, me përjashtim, gjyqtari i Gjykatës së Apelit dhe i Gjykatës Themelore përkohësisht mund të transferohet, **por më së shumti për një periudhë kohore prej një viti** të gjykoj në gjykatë tjetër të shkallës së njëjtë ose në gjykatë më të ulët ose nga një departament i specializuar në një departament tjetër, kur për shkak të pengesës dhe përjashtimit të gjyqtarit ose për shkak të vëllimit të rritur në masë të konsiderueshme, për shkak të azhurnitetit të zvogëluar ose për shkak të kompleksitetit të lëndëve, vihet në pikëpyetje puna rrjedhëse e gjykatës.¹²⁹ Kufizimi kohor prej një viti kontribuon në respektimin e specializimit të gjyqtarëve, megjithatë kishte raste kur gjyqtarët transferoheshin më shumë herë në gjykatë tjetër.

Kritika në publik kishin edhe ndryshimet e shpeshta të kalendarit vjetor veçanërisht në Gjykatën Themelore Shkup 1. Në Strategjinë për reformë të sektorit të jurisprudence, sa i përket përmirësimit të cilësisë së drejtësisë, parashikohet të rritet specializimi i gjyqtarëve dhe të kufizohet mundësia e risistematizimit të gjyqtarëve në departamente të ndryshme në kuadër të gjykatave, praktikë kjo e cila shpesh përdoret në Gjykatën Themelore Shkup 1 dhe në Gjykatën Supreme.¹³⁰

127 <https://rm.coe.int/-/80-18-22-16808cc861>

128 Ligji për gjykatat, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 58/2006, 62/2006, 35/2008, 150/2010, 83/2018 dhe 198/2018.

129 Ibid.

130 Strategjia për reformë të sektorit të jurisprudence për periudhën kohore 2017 – 2022, e aksesshme në: <http://www.pravda.gov.mk/Upload/Documents/2017-2022.pdf>

Kjo masë e Strategjisë u konstatua edhe në Raportin e fundit të Komisionit Evropian për RM.¹³¹ Konform Strategjisë së re dispozitat ligjore për Kalendarin vjetor të punës duhet të sigurojnë të vendoset profili i gjyqtarit për veprim ndaj lëndëve të caktuara, me ç'rast do të mbahet llogari për raportin e kompleksitetit të lëndës me përvojën e gjyqtarit, përkatësisht me stazhin gjyqësor të gjyqtarit.¹³² Në Strategji është parashikuar masa për baza dhe kufizime ligjore për ndryshimin e jashtëzakonshëm të Kalendarit vjetor për punën e gjykatave gjatë vitit.¹³³

Nga fokus grupet rezultoi nevoja që në ligj të ofrohet mundësia me kërkesë të vet gjyqtarit të mund të transferohet në gjykatë tjetër, përkatësisht të mundësohet mobiliteti i gjyqtarëve jo vetëm përmes delegimit nga ana e Këshillit Gjyqësor.

Dyshime më të mëdha sa i përket Ligjit për gjykata krijojnë pikërisht çështjet e zgjedhjes dhe avancimit të gjyqtarëve.

Në Strategji është parashikuar të inkorporohen kritere për avancim të cilat do të korrespondojnë me stazhin e gjyqtarit, rëndësinë, llojin dhe kompleksitetin e lëndëve, notimin profesional.¹³⁴ Sa i përket gjendjes aktuale në Strategji është konstatuar se Këshilli Gjyqësor pa ndonjë argument të caktuar vendos dhe publikon se cilët gjyqtarë avancohen (të zgjedhur në gjykatë më të lartë), pa u theksuar shkaqet për të cilat këta gjyqtarë llogariten si më të mirë.

Në përputhje me Ligin për gjykata, gjyqtarët dhe gjyqtarët-porotë i zgjedh dhe shkarkon Këshilli Gjyqësor i RM.¹³⁵ Kushtet e përgjithshme të cilat duhet t'i përmbushin gjyqtarët janë rregulluar në nenin 45 të Ligjit për gjykata, ndërsa kushtet e veçanta për zgjedhjen e gjyqtarëve janë rregulluar në nenin 46 të Ligjit për gjykata. Kushtet dhe procedura e zgjedhjes së kryetarit janë rregulluar në nenin 47 të ligjit.

Hulumtimi i realizuar në terren e vë në dukje problemin që ka të bëjë me kushtet e zgjedhjes dhe avancimit të gjyqtarëve.

Në lidhje me zgjedhjen e gjyqtarëve, mendimet ishin të ndara. Një pjesë e të anketuarve mendojnë se duhet t'u lihet hapësirë për hyrje jashtë nga Akademia për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë edhe bashkëpunëtorëve profesionalë me më shumë stazh në gjykata.¹³⁶ Si problem për paraqitje të një numri të madh të bashkëpunëtorëve profesionistë në AGJPP u theksuan kriteret për hyrje në AGJPP.¹³⁷ Një pjesë e të anketuarve janë të mendimit se hyrja duhet të bëhet vetëm përmes

131 Raporti i Komisionit Evropian për Republikën e Maqedonisë për vitin 2018, i aksesshëm në: <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20180417-the-former-yugoslav-republic-of-macedonia-report.pdf>

132 Strategjia për reformë të sektorit të jurisprudencës për periudhën kohore 2017 – 2022, e aksesshme në: <http://www.pravda.gov.mk/Upload/Documents/2017-2022.pdf>


133 Strategjia për reformë të sektorit të jurisprudencës për periudhën kohore 2017 – 2022, e aksesshme në: <http://www.pravda.gov.mk/Upload/Documents/2017-2022.pdf>

134 Strategjia për reformë të sektorit të jurisprudencës për periudhën kohore 2017 – 2022, e aksesshme në: <http://www.pravda.gov.mk/Upload/Documents/2017-2022.pdf>

135 Neni 41 dhe 42 të Ligjit për gjykata, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 58/2006, 62/2006, 35/2008, 150/2010, 83/2018 dhe 198/2018

136 U potencua stazhi prej 10 vitesh.

137 Mesatarja si kusht për zotërimin e gjuhës së huaj ka ndryshuar me Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për Akademinë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë nga muaji shtator i vitit 2018.



Akademisë.¹³⁸ Si shkak theksuan se koncepti i Akademisë është mirë i menduar, edhe pse nevojitet përmirësimi i programeve dhe përfshirje më të madhe të mësimit praktik. Sipas tyre, njohurinë që mund ta fitojnë kandidatët e ardhshëm për gjyqtarë, nuk do të mund të arrihet vetëm me shkrimin e aktgjykimeve nëpër zyra, siç është rasti me bashkëpunëtorët profesionistë. Sa i përket hyrjes së praktikientëve të tjerë juridikë, një pjesë e të anketuarve mendojnë se sistemi i vendosur në këtë mënyrë nuk duhet të lejoj hyrje vetëm të prokurorëve, meqë konform zgjidhjes ekzistuese edhe ata shkojnë në trajnim në AGJPP, megjithatë sipas mendimit të tyre ata janë palë në procedurë dhe nuk kanë përvojë për të shkruar aktgjykime.¹³⁹ Kishte edhe propozime për hyrjen e praktikientëve të tjerë juridikë, gjyqtarë të gjykatës ndërkombëtare dhe profesorë nga fusha e së drejtës por në instancat më të larta të gjyqësorit.¹⁴⁰ Ekzistojnë edhe mendime për ndryshimin e konceptit për hyrje në Akademinë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë. Me fjalë të tjera, u theksua se duhet që AGJPP të hapet për të gjitha profesionet juridike. U propozua të inkorporohet kuota shtetërore, e cila do të finanohet nga shteti, ndërsa të gjithë të tjerët ta paguajnë çmimin për hyrje dhe për ndjekjen e procesit mësimor.¹⁴¹ Në nivel vjetor të pranohen sipas nevojës, por jo sipas nevojës së gjykatave dhe sistematizimit të vendeve të punës. Secili që do t'i plotësoj kushtet do të mund të hyjë në Akademi. Në këtë rast të mos ndiqet radhitja kohore e dërgesës së listave nga AGJPP për zgjedhje. Në këtë drejtim u theksua se prokurorët, sipas rregullit, duhet të ndjekin trajnim të njëjtë si edhe avokatët meqë janë palë në procedurë.¹⁴²

Sa u përket kritereve për avancim, të gjithë të anketuarit janë të mendimit se nevojitet rritja e stazhit gjyqësor për avancimin e gjyqtarëve. *Edhe pse stazhi nuk është vendimtar në raport me njohuritë, efikasitetin dhe integritetin e gjyqtarit,* megjithatë është një indikator i mirë se gjyqtari në fjalë ka përvojë të mjaftueshme që t'i vlerësoj dhe të vendos për vendimet e gjykatave më të ulëta.¹⁴³ Përveç kësaj, avancimi i gjyqtarëve nuk duhet të lidhet vetëm me dy notat e njëpasnjëshme të gjyqtarit. Lidhja me dy vjet është problematike nga aspekti se ka gjyqtarë të cilët kanë punuar si gjyqtarë një periudhë të gjatë kohore dhe duhet të vlerësohet puna e tyre e përgjithshme.¹⁴⁴

Një pjesë e të anketuarve theksuan se gjyqtarët në gjyqësinë administrative janë më të privilegjuar.¹⁴⁵ Si e para, hyrja në gjyqësinë administrative është e mundshme drejtpërdrejt nga ndonjë organ shtetëror, ndërsa sistemi i vendosur në këtë mënyrë ofron privilegje të mëdha për avancim, duke i pasur parasysh vitet e nevojshme të stazhit. Kritikat shkonin në drejtim të asaj se gjyqtarit, i cili ka kryer Akademi për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë, i nevojiten 4 vjet përvojë pune që të zgjidhet në Gjykatën Administrative, ndërsa hyrje në Gjykatën Administrative kanë edhe juristët të cilët punojnë në ndonjë organ shtetëror me përvojë pune

138 Këtë qëndrim e kishin një pjesë e gjyqtarëve nga fokus grupet në Shtip dhe Gostivar.

139 Qëndrimi i gjyqtarit nga fokus grupi në Shtip 10.10.2018.

140 Këtë qëndrim e kishin një pjesë e gjyqtarëve nga fokus grupet.

141 Intervistë me ekspert juridik, më datë 12.11.2018.

142 Intervistë me ekspert juridik, më datë, 12.11.2018.

143 Këtë qëndrim e kishin të gjithë gjyqtarët pjesëmarrës në fokus grupet dhe të gjithë gjyqtarët dhe ekspertët e intervistuar.

144 Qëndrimi i gjyqtarit nga fokus grupi në Gostivar, më datë 22.10.2018 dhe i gjyqtarit në fokus grupin në Shkup, më datë 15.10.2018.

145 Këtë qëndrim e kishin gjyqtarët fokus grupit në Shtip, Gostivar dhe Manastir dhe një pjesë e gjyqtarëve dhe ekspertëve juridik të cilët u intervistuan.

prej 5 vitesh. Në këtë mënyrë lehtësohet mënyra e hyrjes jashtë AGJPP, ndërsa gjyqtarët nga gjykatat themelore, disa prej tyre edhe me Akademi të kryer, janë në pozitë më të pafavorshme. Kritika e njëjtë kishte të bëjë edhe me hyrjen në Gjykatën e Lartë Administrative. Sipas zgjidhjes ekzistuese gjyqtari i Gjykatës Administrative, si gjykatë e specializuar e shkallës së parë, në mënyrë të drejtpërdrejt mund të zgjidhet në Gjykatën Supreme si gjykatë më e lartë. Megjithatë, kjo është problematike meqë në Gjykatën Supreme nuk ka materie administrative. Me këtë mënyrë të zgjedhjes dhe avancimit mund të arrihet deri në Gjykatën Supreme pa përvojë paraprake në materien civile ose penale. Ekziston edhe qëndrimi se nevojitet hyrja nga organi shtetëror, përkatësisht nga Administrata e gjyqësisë administrative, meqë ata më së miri e njohin funksionimin e Administratës dhe materien administrative.¹⁴⁶Në këtë drejtim, nëse shkohet me hyrjen vetëm përmes Akademisë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë nevojitet një program i përshtatur për Gjyqësinë Administrative.¹⁴⁷

Kritika i janë adresuar edhe praktikës së Këshillit Gjyqësor në lidhje me avancimin e gjyqtarëve, në drejtim të transparencës më të madhe që ka të bëjë me kriteret sipas të cilave janë udhëhequr gjatë zgjedhjes të një kandidati të caktuar.¹⁴⁸ Vendimet duhet të arsyetohen mirë dhe të publikohen, me qëllim që të njoftohet publiku dhe kasta profesionale.¹⁴⁹

Opinionet në lidhje me zgjedhjen e kryetarit të gjykatës përkatëse janë të ndara.¹⁵⁰ Një pjesë e publikut profesionist mendon se zgjedhja e kryetarit duhet të kufizohet për gjykatën përkatëse. Përfitimet nga zgjidhja e këtillë konsistojnë me atë që kryetari i zgjedhur në këtë mënyrë më së miri e njeh punën e gjykatës, mund të veproj në mënyrë reale dhe funksionale ndaj lëndëve konkrete në një gjykatën konkrete.¹⁵¹Ka qëndrime se nuk duhet të kufizohet zgjedhja e kryetarit vetëm nga gjyqtarët e gjykatës konkrete. Mundet edhe gjyqtari nga një gjykatë tjetër ta organizoj mirë punën e gjykatës në të cilën është zgjedhur. Zgjedhja e kryetarit, para së gjithash, varet nga personaliteti. Megjithatë, në mënyrë të saktë duhet të përcaktohet në ligj, se cilat janë autorizimet e kryetarit dhe organizimi i gjykatave dhe gjyqtarëve.¹⁵²

Në Strategji është parashikuar përcaktimi i kriterëve për zgjedhjen e gjyqtarit-porotë, si dhe rritja e kompensimit të parashikuar për punën e tyre.¹⁵³ Në ndryshimet e Ligjit për gjykata, nga muaji maj i vitit 2018, kushtet që të bëhesh gjyqtar-porotë u ngritën në një shkallë më të lartë (duke e përfshirë edhe provimin e testit të integritetit), ndërsa konform ndryshimeve të propozuara të fundit parashikohet që Kodeksin e etikës gjyqësore të gjyqtarit dhe gjyqtarit-porotë ta miratoj Gjykata Supreme, kështu që dispozitat e njëjta të mund të aplikohen edhe mbi të njëjtët.

146 Intervistë me ekspert juridik, më datë 12.11.2018.

147 Intervistë me ekspert juridik, më datë 12.11.2018.

148 Këtë qëndrim e kishin një pjesë e gjyqtarëve të fokus grupeve në Shtip, Shkup dhe Gostivar.


149 Qëndrimi i gjyqtarit në fokus grupin Gostivar, më datë 22.10.2018.

150 Në përputhje me opinionet e shpalosura nga hulumtimi në terren qëndrimet e të gjithë gjyqtarëve ishin të ndara, si edhe opinionet e gjyqtarëve të intervistuar.

151 Intervistë me gjyqtar

152 Qëndrimi i gjyqtarit në fokus grupin në Gostivar, më datë 22.10.2018.


153 Strategjia për reformë të sektorit të jurisprudencës për periudhën kohore 2017 -2022 me Plan Vepërim, e aksesshme në: <http://www.pravda.gov.mk/Upload/Documents/2017-2022.pdf>




3.2 Opsione në lidhje me zgjedhjen dhe avancimin e gjyqtarëve dhe ndikimi i tyre

3.2.1 Opsioni – Zgjidhja ekzistuese në lidhje me zgjedhjen dhe avancimin e gjyqtarëve, sistematizimi nga një departament në tjetrin, si dhe transferimi i përkohshëm i gjyqtarëve në gjykatë tjetër.

Konform analizës së gjendjeve në këtë fushë dhe hulumtimeve të realizuara në terren, të elaboruara më lartë, opsioni i këtillë do të kontribuoj në drejtim të rritjes shtesë të mosbesimit në sistemin e jurisprudencës, si nga ana e qytetarëve ashtu edhe nga vet kasta profesionale. Ky opsion nuk i adreson edhe qëndrimet e gjyqtarëve.




“Me delegimin e gjyqtarëve nuk reduktohet kualiteti i gjykatës prej të cilës delegohen gjyqtarët, meqë bëhet ndryshim edhe në kalendarin dhe nuk merret parasysh specializimi i gjyqtarëve.” – deklaratë e gjyqtarit




“Kandidati nga Akademia për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë nuk mund të zgjidhet në Gjykatën Administrative, atij i nevojiten 4 vjet stazh gjyqësor që të zgjidhet në Gjykatën Administrative. Për dallim nga kjo në Gjykatën Administrative mund të zgjidhet ndonjë nga organi shtetëror me numër të nevojshëm të viteve të stazhit. Duhet të mundësohet hyrja edhe në Gjykatën Administrative përmes Akademisë.” – deklaratë e gjyqtarit.

Përveç kësaj, me këtë zgjidhje nuk adresohen rekomandimet nga Raporti i Pribe, rekomandimet e raporteve ndërkombëtare, si dhe përcaktimet e Strategjisë për reformë të sektorit të jurisprudencës për periudhën kohore 2017 – 2022.




“Gjyqtarët nga Gjyqësia administrative janë të privilegjuar sa i përket avancimit. Gjyqtari nga Gjykata Administrative si gjykatë e shkallës së parë mund të zgjidhet në mënyrë të drejtpërdrejt në Gjykatën Supreme. Nga ana tjetër, në Gjykatën Supreme e trajtojnë materien penale dhe civile të cilën nuk e kanë trajtuar.” – deklaratë e gjyqtarit.



“Nuk është në rregull një gjyqtar i ri me përvojë katërveçare të vendos sipas ankesës ndaj vendimit tim. Duhet të rritet stazhi i viteve të cilat edhe pse nuk janë vendimtare, paraqesin një indikator të mirë për njohuritë e gjyqtarit dhe një indikator i mirë se mund të vendos në mënyrë të drejtë duke e pasur parasysh përvojën e tij të punës dhe të jetës” – deklaratë e gjyqtarit

3.2.2 Opsioni – Ndryshimi i dispozitave në lidhje me zgjedhjen dhe avancimin e gjyqtarëve, sistematizimin prej njërit departament në tjetrin, si dhe transferimi i përkohshëm i gjyqtarëve në gjykatë tjetër.

- 
- Kufizimi i mundësisë për transferimin dhe sistematizimin në departament tjetër;
 - Gjyqtarët me stazh dyveçar të gjykojnë lëndë më të lehta;
 - Inkorporimi i mundësisë për pranim në Gjykatën Administrative nga Akademia;
 - Revidimi i kriterëve për avancim;
 - Rritja e viteve të stazhit të gjyqtarit për avancimin e gjyqtarëve;
 - Shfuqizimi i mundësisë për avancimin e drejtpërdrejt nga Gjykata Administrative në Gjykatën Supreme;

Një pjesë e madhe e problemeve në këtë pjesë të përfshira në raportet ndër-kombëtare, opinionet, Strategjinë për reformë të sektorit të jurisprudencës dhe hulumtimi i realizuar në terren, tejkalohe me ndryshimet e propozuara ligjore të publikuara në ENER.¹⁵⁴

Konform Strategjisë dispozitat e reja ligjore lidhur me Kalendarin vjetor për punë duhet të mundësojnë që të vendoset profili i gjyqtarit për të vepruar ndaj llojeve të caktuara të lëndëve, me ç'rast do të mbahet llogari për proporcionin e kompleksitetit të lëndës me përvojën e gjyqtarit, më saktë me stazhin gjyqësor të gjyqtarit.¹⁵⁵ **Dispozita e këtillë nga Strategjia u adresua edhe me inkorporimin e kategorisë gjyqtarë të rinj, konform ndryshimeve të propozuara ligjore.**¹⁵⁶ Përqindja konsiston me atë se periudha dyvjeçare është e mjaftueshme për të arritur profesionalizëm të mjaftueshëm gjyqësor të gjyqtarëve të rinj që të mund të përfshihen në Kalendarin e rregullt të lëndëve rrjedhëse, ndërsa konform rekomandimit të Misionit për vlerësim të TAIEKS për trajnimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë nga data 23.04.2018.¹⁵⁷ Nga hulumtimi në terren, veç tjerash, rezultoi edhe ajo se nevojitet që gjyqtarët e sapo zgjedhur të gjykojnë lëndë më të lehta.

Sa i përket masës së parashikuar me Strategjinë për bazat ligjore dhe kufizimin për ndryshimin e jashtëzakonshëm të Kalendarit vjetor për punë të gjykatave brenda vitit, kjo masë nuk është parashikuar në ndryshimet e propozuara të Ligjit për gjykata.¹⁵⁸ Megjithatë, nga të dhënat e fituara nga hulumtimi në terren nxirret në pah fakti se kufizimi i këtillë kohor mund të shkaktoj probleme në praktikë, meqë ndonjëherë gjykatat kanë problem me ndryshimin e shpeshtë të Kalendarit vjetor.¹⁵⁹

Problemet që paraqiten me transferimin e shumëfishtë të gjyqtarëve në gjykatë tjetër ose sistematizimi në departament tjetër, përfshihen me ndryshimet e propozuara, përkatësisht parashikojnë se pas skadimit të kohës për të cilën gjyqtari është transferuar të punoj në gjykatë tjetër ose në departament tjetër të specializuar detyrimisht kthehet në punë në gjykatën, përkatësisht në departamentin e specializuar nga i cili është transferuar.¹⁶⁰

Sipas propozimit të Komisionit të Venecias inkorporohen kufij në rast të transferimit të gjyqtarit në gjykatë tjetër ose në rast të sistematizimit në gjykatë më të ulët, për shkak të situatave të caktuara. Në ligjin ekzistues parashikohet se gjyqtari

154 Propozim ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për gjykata, i publikuar në ENER, data 09.11.2018, https://ener.gov.mk/default.aspx?item=pub_regulation&subitem=view_reg_detail&itemid=kLr1ETMDC-CI9xjhgAz2g==

155 Strategjia për reformë të sektorit të jurisprudencës për periudhën kohore 2017 – 2022, e aksesshme në: <http://www.pravda.gov.mk/Upload/Documents/2017-2022.pdf>

156 Ibid.

157 Propozim ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për gjykata, i publikuar në ENER, viti 09.11.2018, https://ener.gov.mk/default.aspx?item=pub_regulation&subitem=view_reg_detail&itemid=kLr1ETMDC-CI9xjhgAz2g==

158 Strategjia për reformë të sektorit të jurisprudencës për periudhën kohore 2017 – 2022, e aksesshme në: <http://www.pravda.gov.mk/Upload/Documents/2017-2022.pdf>

159 Si shkaqe u theksuan pensionimi i një numri të caktuar të gjyqtarëve.

160 Propozim ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për gjykata, i publikuar në ENER, data 09.11.2018, https://ener.gov.mk/default.aspx?item=pub_regulation&subitem=view_reg_detail&itemid=kLr1ETMDC-CI9xjhgAz2g==

mund të transferohet ose sistematizohet më së shumti një vit. Me propozim të Komisionit të Venecias inkorporohet edhe kufizimi se deri kur do të llogaritet ai një vit. **Me zgjidhjen e propozuar, transferimi dhe sistematizimi do të bëhet më së shumti një herë brenda 5 viteve.** Me zgjidhjen e këtillë pamundësohet që transferimi dhe sistematizimi të shfrytëzohen si forma të presionit.¹⁶¹

Sa i përket mbrojtjes juridike të gjyqtarëve në lidhje me disa masa të caktuara të cilat ndërmerren ndaj gjyqtarëve, inkorporohet e drejta e kundërshtimit në mbledhjen e përgjithshme të Gjykatës Supreme si një lloj garancie. Meqë në procesin e ndryshimit, deri më tani, në Ligjin për Këshillin Gjyqësor ekzistonte garanci e të drejtës së kundërshtimit në rast të shkarkimit ose përgjegjësisë disiplinore por për masat tjera që ndërmerren ndaj gjyqtarëve është bërë lëshim që të rregullohet. Garancia e këtillë inkorporohet në Ligjin për gjykata.¹⁶²

Mundësia e mobilitetit të gjyqtarëve, përkatësisht mundësia e konkurrimit në gjykatë tjetër të shkallës së njëjtë gjithashtu është parashikuar në ndryshimet e parashikuara të ligjit. Me ndryshimet është parashikuar, gjyqtari i cili është zgjedhur për juridiksionin e një gjykate themelore, pas skadimit të katër viteve të stazhit të pandërprerë si gjyqtar në gjykatën përkatëse, mund të zgjidhet në juridiksionin e një gjykate tjetër themelore dhe gjyqtari i cili është zgjedhur për juridiksionin e një gjykate të apelit pas skadimit të gjashtë viteve të stazhit pandërprerë, si gjyqtar në gjykatën përkatëse, mund të zgjidhet në juridiksionin e gjykatës tjetër të apelit në bazë të kriterëve të cilat janë parashikuar për zgjedhjen në gjykatën e apelit.¹⁶³

Nga hulumtimi i realizuar në terren rezulton se **ndryshimet e propozuara pjesërisht i kënaqin nevojat e gjyqësorit në lidhje me kriteret për zgjedhjen e gjyqtarëve.**

Me këto ndryshime mundësohet hyrja në gjyqësi vetëm përmes Akademisë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë. Në këtë kontekst edhe hyrja në gjyqësinë administrative do të bëhet përmes Akademisë.¹⁶⁴ Në këtë drejtim nevojitet të parashikohet program i veçantë në Akademi i cili do t'u përshtatet kandidatëve të cilët dëshirojnë të konkurrojnë në Gjykatën Administrative.¹⁶⁵ Përfundimisht i vetëm nga kjo është zgjedhja e gjyqtarit nga Gjykata Evropiane për të Drejtat

161 Fjala e ministres së Drejtësisë, Prof. Dr. Renata Deskovska, në tryezën e rrumbullakët për versionin e punës të: "Analizë e vlerësimit të ndikimit të legjislacionit mbi Ligjin për gjykata, data 11.12.2018.

162 Fjala e ministres së Drejtësisë, Prof. Dr. Renata Deskovska, në tryezën e rrumbullakët për versionin e punës të: "Analizë e vlerësimit të ndikimit të legjislacionit mbi Ligjin për gjykata, data, 11.12.2018.

163 Neni 16 nga Propozim ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për gjykata, i publikuar në ENER më datë 09.11.2018.

164 Në nenin 16 të Propozim ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për gjykata, i publikuar në ENER më datë 09.11.2018 parashikohet:

- Për gjyqtar të Gjykatës Administrative mund të zgjidhet personi i cili e ka kryer trajnimin fillestar për gjyqtarë dhe prokurorë publikë ose ka përvojë pune prej më së paku katër vjet stazh të pandërprerë si gjyqtar në gjykatë themelore deri në momentin e paraqitjes për zgjedhje, e cila nga organi kompetent është vlerësuar me notë pozitive, konform ligjit dhe është në mesin e pesë kandidatëve të rankuar në konkurs.
- Për gjyqtarë në Gjykatën e Lartë Administrative mund të zgjidhet personi i cili ka përvojë pune prej më së paku gjashtë vjet stazh të pandërprerë si gjyqtar në Gjykatën e Apelit ose në Gjykatën Administrative deri në momentin e paraqitjes për zgjedhje dhe i cili nga ana e organit kompetent është vlerësuar me notë pozitive, konform ligjit dhe është në mesin e pesë kandidatëve të rankuar në konkurs.

165 Intervistë me ekspert juridik, më datë 12.11.2018.

e Njeriut, i cili nëse i përmbush kriteret e përgjithshme për zgjedhje të gjyqtarit mund të konkurroj në të gjitha shkallët e gjyqësorit.¹⁶⁶ Në këtë mënyrë adresohen rekomandimet e prezantuara në raportet e Grupit të Ekspertëve të udhëhequr nga Pribe dhe rekomandimet nga Misioni për Vlerësim i TAEX për trajnimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve publik nga data 23.04.2018. Nevojitet në mënyrë plotëse të avancohet trajnimi në Akademinë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë me inkorporimin e mësimin më të madh praktik dhe simulimin e gjykimeve.¹⁶⁷

Gjyqtarët janë të mendimit se nevojitet të rriten vitet e stazhit të nevojshme për avancimin e gjyqtarëve.¹⁶⁸ Në Strategji është parashikuar inkorporimi i kriteve për avancim të cilët do të jenë në **korrelacion me stazhin e gjyqtarit**, peshën, llojin dhe kompleksitetin e lëndëve, notimin profesional.¹⁶⁹ Në ndryshimet e parashikuara të Ligjit janë parashikuar vite të njëjta të stazhit si edhe në zgjidhjen ekzistuese. *Me ndryshimet e propozuara nuk përfshihen masat e parashikuara në Strategjinë, si dhe reagimi i gjyqtarëve të cilët mendojnë se edhe pse stazhi nuk është indikator i mirë se gjyqtari përkatës ka përvojë të mjaftueshme që të mund t'i vlerësoj dhe të mund të vendos për vendimet e gjykatave më të ulëta.* Rritja e viteve të stazhit të nevojshme për avancim e përforcon besimin e gjyqtarëve në lidhje me vendimet e gjykatave më të larta.

Përveç kësaj, për të gjitha shkallët e gjyqësorit parashikohet mundësia Këshilli Gjyqësor të zgjedh gjyqtarë nga pesë kandidatët e parë të rankuar, sipas kriteve ligjore, të paraqitur në konkurs, duke e pasur parasysh të drejtën e diskrecionit për zgjedhjen e gjyqtarit.¹⁷⁰ Me këtë zgjidhje lihet hapësirë që Këshilli Gjyqësor de facto ta bëjë zgjedhjen e gjyqtarëve dhe jo vetëm t'i caktoj. Megjithatë, këtu duhet të merret në konsideratë praktika e deritanishme e Këshillit Gjyqësor për (mos)arsyetimin e aktgjykimeve. *Vendimet në lidhje me (mos)zgjedhjen e gjyqtarëve duhet të elaborohen dhe arsyetohen në detaje, me qëllim që të mos lihet hapësirë për mosbesim si sa u përket vendimeve ashtu edhe sa i përket sistemit të përgjithshëm të jurisprudencës. Nevojitet të ndërtohet praktika e Këshillit Gjyqësor në lidhje me aplikimin e këtyre kriteve me qëllim të përforcimit të besimit në këtë institucion.*

Në ndryshimet e propozuara ligjore lidhur me kriteret për zgjedhjen e kryetarit të gjykatës, rriten vitet e stazhit, përkatësisht nga katër vjet vite stazh rriten në 6 vjet. Me ndryshimet mbetet koncepti i zgjedhjes së kryetarit me stazh të pandërprerë të gjyqtarit në gjykatë të shkallës së njëjtë ose më të lartë. Në këtë rast i lihet e drejta e zgjedhjes Këshillit Gjyqësor nga tre kandidatët e parë të rankuar. *Edhe në këtë rast nevojitet arsyetimi i vendimeve nga ana e Këshillit Gjyqësor për (mos) zgjedhjen e kandidatëve dhe ndërtimin e praktikës për aplikimin e këtyre kriteve.*

166 Neni 16 nga Propozim ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për gjykata, i publikuar në ENER më datë 09.11.2018.

167 Konform deklaratave nga hulumtimi në terren.

168 Të gjithë gjyqtarët nga hulumtimi në terren kishin qëndrim të këfillë.

169 Strategjia për reformë të sektorit të jurisprudencës për periudhën kohore 2017 – 2022, e aksesshmenë: <http://www.pravda.gov.mk/Upload/Documents/2017-2022.pdf>

170 Ibid.

Me konceptin e ri të notimit, i propozuar në Projekt Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit të Këshillit Gjyqësor,¹⁷¹ është parashikuar se notimi i rezultateve të përgjithshme kuantitative dhe kualitative nga puna e gjyqtarit të bëhet kur gjyqtari konkurren për t'u zgjedhur në gjykatë tjetër të shkallës së njëjtë, në gjykatë më të lartë ose për kryetar të gjykatës. Ndryshimet e propozuara ligjore të Ligjit për gjykata korrespondojnë me këtë koncept, përkatësisht njëri nga kushtet për zgjedhje në gjykatë të shkallës së njëjtë, në gjykatë më të lartë ose kryetar të gjykatës është kandidati të jetë notuar me notë pozitive nga organi kompetent.¹⁷² Ky përcaktim korrespondon edhe me opinionet nga hulumtimi në terren, të cilat theksojnë se gjyqtarët janë më të kënaqur nëse merret parasysh puna e tyre shumëvjeçare dhe jo vetëm dy notimet e fundit.

171 Propozim ligj për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për Këshillin Gjyqësor i publikuar në ENER më datë 10.11.2018, i aksesshëm në: https://ener.gov.mk/default.aspx?item=pub_regulation&subitem=view_reg_detail&itemid=zGY7k5safPL8Qo4yOHyKTA==

172 Neni 16 dhe neni 17 të Propozim ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për gjykata, i publikuar në ENER më datë 09.11.2018.

4. NDËRPRERJA DHE SHKARKIMI NGA FUNKSIONI I GJYQTARIT

4.1 Analizë e dokumenteve, rekomandimeve dhe standardeve ndërkombëtare

Sipas Rekomandimit CM/REC(2010)12 të Këshillit të Evropës¹⁷³ procedura disiplinore mund të ngrihet kur gjyqtarët nuk do t'ia dalin t'i kryejnë detyrat e tyre në mënyrë efikase dhe përkatëse. Procedurat e këtilla duhet t'i zbatoj një organ i pavarur ose gjykata me të gjitha garancitë për gjykim të drejtë dhe gjyqtari të ketë të drejtë ta kontestoj vendimin dhe sanksionin. Sanksionet disiplinore duhet të jenë proporcionale.

Komisioni Evropian në Raport Progresin për vitin 2013 ka vlerësuar se legjislacioni, me të cilin rregullohet shkarkimi i gjyqtarëve duhet të pësoj ndryshime, me qëllim që të bëhet në mënyrë precize dhe të parashikueshme.¹⁷⁴ Implementimi i Strategjisë së jurisprudencës është në rrjedhë e sipër dhe rekomandimet relevante të Komisionit të Venecias në lidhje me sistemin e disiplinimit dhe shkarkimit të gjyqtarëve u përfshinë me miratimin e grupit të parë të ndryshimeve të Ligjit për Këshillin Gjyqësor dhe suspendimi i Këshillit për Përcaktimin e Fakteve. Komisioni Evropian rekomandoi që autoritetet shtetërore të miratojnë dhe implementojnë masa të përfshira në Strategjinë për reforma gjyqësore lidhur me sistemet e caktimit dhe avancimit në jurisprudencë, si dhe ta mbrojnë gjyqësorin nga ndikimet politike. Këshilli për Përcaktimin e Fakteve u suspendua në janar të vitit 2018, ndërsa Ligji për Këshillin Gjyqësor u amendua që t'ia kthej përgjegjësitë Këshillit Gjyqësor lidhur me procedurën disiplinore dhe shkarkimin e gjyqtarëve, në përputhje me opinionin e Komisionit të Venecias për vitin 2015.¹⁷⁵

173 <https://rm.coe.int/16807096c1>

174 https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2013/package/brochures/the_former_yugoslav_republic_of_macedonia_2013.pdf

175 Raporti i Komisionit Evropian për Republikën e Maqedonisë, prill 2018, i aksesshëm në: <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20180417-the-former-yugoslav-republic-of-macedonia-report.pdf>

Komisioni i Venecias në opinionin e tij të vitit 2015¹⁷⁶ konstaton ndryshimet e Ligjit për gjykata të vitit 2015 si “ngjarje të mirëseardhura” që kanë të bëjnë me evitimin e dualitetit të bazave për revokimin e gjyqtarëve që ka ekzistuar në sistemin e deriatëhershëm. Me këto ndryshime baza e vetme e revokimit është shkelje serioze disiplinore, ndërkaq inkorporimi i kategorizimit të sjelljes joadekuate në tre grupe: të vogla, të rënda dhe serioze ka rezultuar me kategorizim më të qartë të shkeljeve disiplinore. Sa i përket përfshirjes së kundërvajtjeve në Ligjin për gjykata, si bazë për ngritjen e procedurës disiplinore, Komisioni i Venecias konsideron se një numër i madh i tyre janë formuluar në mënyrë të paqartë. Si për shembull, për bazë të paqartë thekson se gjyqtari mund t’i nënshtrohet procedurës disiplinore nëse “shkakton shkelje më të rënda gjatë punës së gjykatës”. Formulimet e këtilla mund ta hapin portën për interpretime abuzive, madje janë edhe të rrezikshme për pavarësinë gjyqësore. Së dyti, shumë shkelje disiplinore mbivendosen. Kështu, për shembull, në Ligjin për gjykata përcaktohen katër lloje të shkeljeve të cilat e përfshijnë tejkalimin e kufizimeve kohore procedurale dhe tre lloje të shkeljeve që kanë të bëjnë me sjelljen joadekuate të gjyqtarit jashtë kontekstit të punës. Mbivendosjet e rrezikshme të këtilla sipas Komisionit të Venecias mund të krijojnë konfuzion të madh në praktikë. Në këtë aspekt, Komisioni i Venecias propozon që në Ligjin për gjykata të inkorporohet një klauzolë e përgjithshme e cila do të kërkojë që organet disiplinore ta marrin parasysh shkallën e fajit të gjyqtarit.


Me Propozim-Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për gjykata nga muaji maj i vitit 2018 u bënë ndryshime lidhur me bazat e përgjegjësisë së gjyqtarëve.¹⁷⁷ Megjithatë, këto ndryshime nuk i përmbushën pritshmëritë e gjyqtarëve.

Në Raportin e GREKO theksohet se rekomandimi “shkelje disiplinore të cilat vlejné për gjyqtarët të definohe në mënyrë të qartë, ndërsa shtrirja e sanksioneve të zgjerohet, me qëllim që të sigurohet proporcionalitet më i madh dhe shkarkimi i gjyqtarit të mundësohet vetëm për llojet më serioze të shkeljeve, me qëllim që të parandalohet mundësia gjyqtari të shkarkohet vetëm nëse konstatohet se njëri nga vendimet e tij e cenon të drejtën e gjykimit në afat të arsyeshëm” pjesërisht është zbatuar. GREKO thekson se akoma mund të gjenden shkelje të përkufizuara gjerë e gjatë, siç janë “ushtrimi joprofesional, jo në kohë dhe i pakujdesshëm të funksionit të gjyqtarit” (vepër e cila shpeshherë përdoret në praktikë) – në nenin 75, i cili tani përfshin 11 elemente (10 përfshinte në kohën kur e vizituan shtetin). Përveç kësaj lidhur me pjesën e dytë të rekomandimit, neni 75 akoma e parashikon llojin e situatave të cilat rekomandimi kërkon të shfuqizohen (vendim me të cilin cenohet neni 5 dhe 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut). Marrë në përgjithësi, edhe pse ekzistojné përmirësime të caktuara lidhur me shtrirjen e kundërvajtjeve dhe sanksioneve ndërsa sanksionet automatike janë shfuqizuar, kështu që disa elemente të rëndësishme nga të dyja pjesët të këtij rekomandimi në të vërtetë nuk janë zgjidhur.¹⁷⁸

176 Opinioni i Komisionit të Venecias për ligjet për përgjegjësi disiplinore dhe notimin e gjyqtarëve, dhjetor 2015, i aksesshëm në: [http://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=C-DL-AD\(2015\)042-e](http://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=C-DL-AD(2015)042-e)

177 Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për gjykata, i aksesshëm në: <http://sobranie.mk/downloaddocument.aspx?id=afc3055f-2f1a-4599-a4ce-326a9ae5d9d9&t=pdf>

178 Raporti i GREKO, Rrethi i katërt i evaluimit – Parandalimi i korrupsionit lidhur me deputetë, gjyqtarë dhe prokurorët, 22 qershor 2018, i aksesshëm në: <https://rm.coe.int/-/80-18-22-/16808cc861>



Më datë 22 tetor të vitit 2018 Komisioni i Venecias e publikoi opinionin lidhur me Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Këshillin Gjyqësor dhe Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për gjykata.¹⁷⁹ Opinioni ka të bëjë me ndryshimet e fundit ligjore nga muaji maj i vitit 2018 dhe ngërthen tri tema kryesore: parimet për përgjegjësi disiplinore të gjyqtarëve, procedurat dhe trupat disiplinore dhe notimi i gjyqtarëve. Sa u përket aspekteve të tjera (siç është sistemi i rekrutimit të gjyqtarëve, përbërja e Këshillit Gjyqësor etj.) Komisioni i Venecias u sugjeron autoriteteve maqedonase t'u referohen opinioneve të tij paraprak dhe standardeve relevante evropiane.¹⁸⁰

Komisioni i Venecias ndryshimet i vlerësoi si pozitive, megjithatë bëri edhe rekomandime konkrete për ndryshimet dhe përmirësimet e ardhshme të teksteve ligjore. Sipas Komisionit të Venecias duhet të precizohet në mënyrë shtesë funksioni i filtrit në sistemin e ri të procedurës disiplinore. Duhet të precizohet në mënyrë shtesë roli i mbledhjes së Këshillit në raport me Komisionin për përcaktimin e përgjegjësisë së gjyqtarit, kryetarit të gjykatës dhe Këshillit të ankesave (a është i obliguar Këshilli Gjyqësor me propozimin e Komisionit dhe kush e ka vendimin përfundimtar në rastin e procedurës disiplinore në rastin kur Këshilli me ankesë do ta kthej lëndën me udhëzime); duhet të shqyrtohet në cilat lëndë nevojitet 2/3 e shumicës në Këshillin Gjyqësor dhe çka nëse kjo shumicë nuk arrihet. Efektiviteti i sistemit të notimit duhet të revidohet pas një periudhe të caktuar të testimit; përgatitjen e sistemit të notimit mund ta bëjë edhe vet Këshilli Gjyqësor; duhet të precizohet në mënyrë shtesë roli i notimeve të jashtëzakonshme në procesin e avancimit. Nenet 75 dhe 76 nga Ligji për gjykata duhet të riformulohen, me qëllim që të evitohet paralelizmi dhe të reflektohet distinkcioni i bërë me Kushtetutë midis “ushtrimit joprofesional dhe të pandërgjegjshëm të funksionit të gjyqtarit” dhe “shkelje më e rëndë disiplinore”; në ligj duhet të qëndroj qartë se shkarkimi i gjyqtarit për gabim profesional është i mundshëm vetëm nëse konstatohen dy parakushte: faji i gjyqtarit të prekur (në formë të pakujdesisë së qëllimshme ose evidente) dhe pesha e gabimit dhe pasojat nga e njëjta. Sidoqoftë, gjyqtarët individualisht nuk duhet të bartin përgjegjësi për funksionimin e keq të sistemit gjyqësor në tërësi. Edhe pse gjyqtarët duhet ta aplikojnë praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut ata nuk duhet të dënohen për gabimet gjatë ushtrimit së kësaj detyre. Kur Gjykata Evropiane konstatoi cenimin e Konventës në rastin në të cilin veprohet nga ana e gjyqtarit, kjo asnjëherë nuk duhet automatikisht të çojë në shkarkimin e gjyqtarit ose në uljen e notës së përgjithshme në procesin e notimit të punës së gjyqtarit.

179 Komisioni i Venecias, opinionin për Ligjin për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për Këshillin Gjyqësor dhe Ligjin për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për gjykata, 22 tetor 2018, i aksesshëm në: [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2018\)022-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2018)022-e)

180 Ibid. faqe 4.

4.2 Gjendjet në Republikën e Maqedonisë në lidhje me bazat e përgjegjesisë së gjyqtarëve

Bazat e ndërprerjes dhe shkarkimit të gjyqtarëve janë rregulluar me Kushtetutë.¹⁸¹ Në kapitullin 5 të Ligjit për gjykata, në mënyrë të detajuar trajtohen bazat e ndërprerjes dhe shkarkimit nga funksioni i gjyqtarit.¹⁸²

Përgjegjësia disiplinore e gjyqtarëve është rregulluar me dy ligje të ndryshëm, Ligjin për gjykata dhe me Ligjin për KGJRM. Disa nga bazat e përgjegjesisë disiplinore nuk janë precize dhe mbivendosen, e që rezultojnë me konfuzion dhe subjektivizëm gjatë zhvillimit të procedurave dhe shqiptimit të sanksioneve. Vërehet edhe se nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë midis disa shkeljeve disiplinore dhe fajit të gjyqtarit si individ. Kjo rezultojnë me moskëzistimin e baraspeshës së vërtetë midis përgjegjesisë dhe pavarësisë së gjyqtarëve.¹⁸³ Në Strategjinë për reformë të sektorit të jurisprudencës është parashikuar inkorporimi i mekanizmave funksional dhe transparent për përgjegjësinë e gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë, inkorporim të kriterëve objektive dhe të matshme për përcaktimin e përgjegjesisë së gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë, pluralizimi i sanksioneve, shkarkim vetëm për shkelje më të rënda dhe të vazhdueshme disiplinore.¹⁸⁴

Bazat e përgjegjesisë së gjyqtarëve, të përcaktuara në Ligjin për gjykata, u ndryshuan në muajin maj të vitit 2018, me qëllim që t'i adresojnë rekomandime e opinionit të Komisionit të Venecias. **Megjithatë, ndryshimet e këtilla u kritikuan nga kasta profesionale, vërejtje lidhur me ndryshimet kishte edhe në Raportin e fundit të GREKO¹⁸⁵ dhe në opinionin e Komisionit të Venecias nga muaji tetor i vitit 2018.**¹⁸⁶

Hulumtimi i realizuar në terren e vë në dukje pakënaqësinë e gjyqtarëve dhe ekspertëve juridikë në lidhje me bazat e përgjegjesisë, veçanërisht bazat të cilat rezultojnë me shkarkimin e gjyqtarëve. Ndryshimet e fundit nga muaji maj i vitit 2018 nuk janë në nivelin e detyrës për mbrojtjen e pavarësisë së gjyqësorit. Gjyqësori duhet të avancohet dhe jo të disiplinohet.¹⁸⁷ Edhe pse bëhet fjalë për ligj sistemor, megjithatë, nuk duhet të lihet hapësirë për negociata politike, veçanërisht sa u përket bazave dhe procedurës për përcaktimin e përgjegjesisë, e cila duhet të jetë garant i pavarësisë gjyqësore. Ekzistojnë baza të definuara gjerë e gjatë të cilat rezultojnë me shkarkimin e gjyqtarëve.¹⁸⁸ Megjithatë, gjyqtarët u

181 Neni 99 i Kushtetutës së RM.

182 Ligji për gjykata, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 58/2006, 62/2006, 35/2008, 150/2010, 83/2018 dhe 198/2018.

183 Strategjia për reformë të sektorit të jurisprudencës 2017 – 2022, faqe 16 – 17, e aksesshme në: <http://www.pravda.gov.mk/Upload/Documents/2017-2022.pdf>

184 Ibid. faqe. 18.

185 Raporti i GREKO, Rrethi i katërt i evaluimit – Parandalimi i korrupsionit lidhur me deputetë, gjyqtarë dhe prokurorë, 22 qershor 2018, i aksesshëm në: <https://rm.coe.int/-80-18-22-/16808cc861>

186 Komisioni i Venecias, opinionin për Ligjin për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për Këshillin Gjyqësor dhe Ligjin për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për gjykata, 22 tetor 2018, i aksesshëm në: [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2018\)022-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2018)022-e)

187 Intervista me gjyqtar, më datë 12.11.2018.

188 Qëndrim të këtyllë patën të gjithë të anketuarit nga hulumtimi në terren.


nënshtrohen edhe përgjegjësishë penale për punën e tyre.¹⁸⁹ Ekziston paralelizëm tek bazat. Dy baza parashikonin punë joprofesionale dhe të pandërgjegjshme dhe shkelje të vrazhdë të kodeksit të gjyqtarit. Nevojitet një distinkcion nga kompetenca e rregullt e gjykatave më të larta meqë ato vendosin sipas mjeteve juridike dhe bazave për punë joprofesionale dhe të pandërgjegjshme dhe sipas shkeljes së rëndë disiplinore.¹⁹⁰ Përveç kësaj, nuk merret parasysh edhe faji i gjyqtarit dhe pesha e gabimeve të tij kur përcaktohen bazat e përgjegjësishë.

Autorizime të shumta ka në dispozicion kryetari në lidhje me përgjegjësishë disiplinore.¹⁹¹ Autorizimet e këtylla mund të rezultojnë me njoftimin e Këshillit Gjyqësor edhe në situatë kur është bërë gabim shumë i vogël nga ana e gjyqtarit. Aq më shumë duke e marrë parasysh faktin se në Ligjin për gjykata është përcaktuar se kryetari i gjykatës shkarkohet nga funksioni nëse nuk parashtron propozim për ngritjen e procedurës për përcaktimin e përgjegjësishë së gjyqtarit në përputhje me ligjin, ndërsa e ka ditur ose e ka pasur për detyrë ta dijë ekzistimin e shkaqeve ligjore.¹⁹² Me ndryshimet e fundit është parashikuar që kryetari mund të shkarkohet nëse nuk e njofton Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë për shkeljen e kryer më të rëndë disiplinore nga ana e gjyqtarit për të cilin hapet procedurë për përgjegjësishë disiplinore të gjyqtarit, në përputhje me nenin 76 paragrafin (2) të Ligjit për gjykata i cili ka të bëjë me pamundësimin e ushtrimit të mbikëqyrjes mbi punën e gjyqtarit nga ana e gjykatës më të lartë.

4.3 Opsione lidhur me bazat e përcaktimit të përgjegjësishë të definuara në Ligjin për gjykata dhe ndikimi i tyre

4.3.1 Opsioni – Bazat e pandryshuara për përcaktimin e përgjegjësishë të definuara në Ligjin për gjykata¹⁹³

Zgjidhja e këtyllë e rrezikon pavarësinë gjyqësore.¹⁹⁴ Të gjithë të anketuarit e vënë në dukje faktin se ky opsion nuk është i pranueshëm si dhe të ndryshohen bazat për përgjegjësishë e gjyqtarëve.



“Gjyqësori duhet të avancohet, dhe jo të disiplinohet” – qëndrim i gjyqtarit

189 Konform qëndrimeve të prezantuara në fokus grupe

190 Intervistë me Denis Preshova, më datë 09.11.2018.

191 Qëndrim i gjyqtarit, fokus grupi në Gostivar, më datë 22.10.2018.

192 Neni 79, paragrafi 1, alineja 12 nga Ligji për gjykata

193 Bazat u ndryshuan me Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për gjykata, “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 83/2018

194 Konform deklaramëve të gjyqtarëve nga hulumtimi në terren.

Ko zgjidhje nuk i adreson rekomandimet e përfshira në Raportin e GREKO¹⁹⁵ dhe opinionin e Komisionit të Venecias,¹⁹⁶ si dhe masat e përcaktuara në Strategjinë për reformë të sektorit të jurisprudencës.

4.3.2 Opsioni – Ndryshimi i bazave për përcaktimin e përgjegjësisë të definuara në Ligjin për gjykata¹⁹⁷

- Ndryshimi i bazave të përgjegjësisë, me ç'rast do të reflektoj distinkcioni i bërë në Kushtetutë ndërmjet “ushtrimit joprofesional dhe të pandërgjegjshëm të funksionit të gjyqtarit” dhe “shkeljes më të rëndë disiplinore”;
- Gradacioni i bazave për shkarkim;
- Evitimi i paralelizmit dhe bazave të dyfishta;
- Shkarkimi i gjyqtarit për gabimin profesional vetëm nëse konstatohen dy parakushte: faji i gjyqtarit të prekur (në formë të pakujdesisë së qëllimshme dhe evidente) dhe pesha e gabimit dhe pasojat nga i njëjti;
- Shkelja e neneve 6 dhe 5 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut me automatizëm nuk duhet të rezultojë me shkarkimin e gjyqtarit;
- Procesi i notimit të gjyqtarëve duhet të dallohet nga procedura disiplinore;
- Detyrë e kryetarëve për ngritjen e procedurës për përcaktimin e përgjegjësisë së gjyqtarit ka të bëjë vetëm me shkeljet evidente dhe të vrazhda të kryera nga ana e gjyqtarëve, të njohura për kryetarin, dhe jo çdo parregullsi potenciale;

Ndryshimet e propozuara të Ligjit për gjykata të publikuara në ENER,¹⁹⁸ lidhur me bazat e përgjegjësisë së gjyqtarëve, janë në funksion të fuqizimit të pavarësisë së gjyqtarëve dhe të gjyqësorit. Ndryshimet e propozuara janë në drejtim të përmbushjes së rekomandimeve të dhëna në Raportin e GREKO¹⁹⁹ dhe opinionit të Komisionit të Venecias,²⁰⁰ si dhe masat e përcaktuara në Strategjinë për reformë të sektorit të jurisprudencës. Këto ndryshime korrespondojnë me rekomandimet nga hulumtimi i realizuar në terren.

195 Raporti i GREKO, Rrethi i katërt i evaluimit – Parandalimi i korrupsionit lidhur me deputetë, gjyqtarë dhe prokurorë, 22 qershor 2018, i aksesshëm në: <https://rm.coe.int/-80-18-22-/16808cc861>

196 Komisioni i Venecias, opinioni për Ligjin për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për Këshillin Gjyqësor dhe Ligjin për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për gjykata, 22 tetor 2018, i aksesshëm në: [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2018\)022-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2018)022-e)

197 Bazat u ndryshuan me Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për gjykata, “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 83/2018.

198 Propozim ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për gjykata i publikuar në ENER, më datë 09.11.2018, https://ener.gov.mk/default.aspx?item=pub_regulation&subitem=view_reg_detail&itemid=kL-r1ETMDCCI9xjhgdaZ2g==

199 Raporti i GREKO, Rrethi i katërt i evaluimit – Parandalimi i korrupsionit lidhur me deputetë, gjyqtarë dhe prokurorë, 22 qershor 2018, i aksesshëm në: <https://rm.coe.int/-80-18-22-/16808cc861>

200 Komisioni i Venecias, opinioni për Ligjin për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për Këshillin Gjyqësor dhe Ligjin për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për gjykata, 22 tetor 2018, i aksesshëm në: [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2018\)022-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2018)022-e)

Me ndryshimet e propozuara bëhet gradacioni i bazave për shkarkim, më saktë për formën më të lehtë të shkëljes së bazave për shkëlje më të rëndë disiplinore, gjyqtarit mund t'i shqiptohet masë disiplinore.²⁰¹ Sa u përket bazave për shkarkimin e gjyqtarëve merret parasysh edhe pesha e shkëljes së bërë dhe faji i gjyqtarit.²⁰²

Si punë joprofesionale dhe të pandërgjegjshme të gjyqtarit me ndryshimet e propozuara parashikohen 3 elemente: nëse në vazhdimësi nuk i përmbush kriteret për sukses gjatë punës, ndërsa komform kriterëve dhe procedurës së përcaktuar në Ligj; pa ndonjë shkak të arsyeshëm nuk i cakton seancat për lëndët të cilat i janë ndarë në punë ose në mënyrë tjetër e zvarrit procedurën ose lëndën nuk e merr në punë; merr në punë lëndë e cila nuk i është shpërndarë përmes sistemit për shpërndarje automatike të lëndëve.²⁰³ Nevojitet precizim shtesë të kriterëve për sukses në punë, përkatësisht meqë koncepti i ri në Ligjin për Këshillin Gjyqësor, monitorimi i punës së gjykatës dhe gjyqtarit do të bëhet në nivel vjetor, me këtë dispozitë monitorimi mund të interpretohet si notim e që mund të rezultojë me shkarkimin e gjyqtarit.²⁰⁴ Rekomandohet të precizohet në mënyrë shtesë dispozita në drejtim të asaj se çka do të nënkuptoj mospërmbushja e kriterëve të suksesit. Në opinionin e Komisionit të Venecias theksohet se procesi i evaluimit duhet të dallohet nga procedura disiplinore.²⁰⁵ Me Ligjin e propozuar për Këshillin Gjyqësor i publikuar në ENER, inkorporohet koncepti i notimit të rezultateve të përgjithshme kuantitative dhe kualitative të punës së gjyqtarit në rastin kur gjyqtari konkurrin që të zgjidhet në gjykatë tjetër të shkallës së njëjtë, në gjykatë më të lartë ose për kryetar të gjykatës. Komisioni i Venecias vë në dukje se ky koncept mund të bartë me vete dilema dhe sfida të reja. Në këtë drejtim, rekomandimi i tyre nuk konsiston me atë që të përjashtohet notimi i rregullt, por duhet të prolongohet afati i notimit. Në këtë drejtim, afati i notimit është prolonguar prej 2 në 4 vjet.²⁰⁶ Në këtë drejtim, rekomandohet që notimi të lidhet me bazat e përgjegjësisë së gjyqtarëve.

Shlyerja e elementeve të tjera nga baza punë joprofesionale dhe e pandërgjegjshme dhe procedurë më e rëndë disiplinore korrespondon me rekomandimin e Komisionit të Venecias dhe e fuqizon pavarësinë e gjyqësorit. Me ndryshimet e propozuara janë reduktuar elementët edhe të shkëljes disiplinore.²⁰⁷ Megjithatë, edhe në rastin e shkëljes më të lehtë ose më të rëndë disiplinore, kryetarit të gjykatës i delegohet e drejta e diskrecionit, në lidhje me ekzistimin e disa nga bazat për shkëlje disiplinore, që ta njoftoj Këshillin Gjyqësor. Në Ligjin për gjykata është përcaktuar se kryetari i gjykatës shkarkohet nga funksioni nëse nuk paraqet propozim për ngritjen e procedurës për përcaktimin e përgjegjësisë së gjyqtarit,

201 Neni 26 nga propozim ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për gjykata, i publikuar në ENER, më datë 09.11.2018.

202 ibid.

203 Neni 27 nga propozim ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për gjykata, i publikuar në ENER, më datë 09.11.2018.

204 Debat për Ligjin për gjykata, më datë 09.11.2018

205 Komisioni i Venecias, opinionin për Ligjin për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për Këshillin Gjyqësor dhe Ligjin për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për gjykata, 22 tetor 2018, faqe 4 i aksesshëm në: [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2018\)022-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2018)022-e)

206 Fjala e ministres së Drejtësisë, Prof. Dr. Renata Deskovska, në tryezën e rrumbullakët për versionin e punës të: "Analizë e vlerësimit të ndikimit të legjislacionit mbi Ligjin për gjykata, viti 11.12.2018.

207 Neni 28 dhe neni 29 nga propozim ligji për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për gjykata i publikuar në ENER më datë 09.11.2018.

konform ligjit, ndërsa e ka ditur ose e ka pasur për detyrë ta dijë ekzistimin e shkaqeve ligjore.²⁰⁸Vërejtjet e Komisionit të Venecias përmes opinionit të fundit konsistojnë me atë se ekzistojnë shumë formulime të paqarta dhe të përgjithësuara për ngritjen e procedurës për përgjegjësinë e gjyqtarëve të specifikuar në nenin 75, 76 dhe 77 të Ligjit për gjykata. Në situatë të këtillë, kryetarët e gjykatave mund të ndihen të obliguar ta paraqesin në Këshillin Gjyqësor çdo incident më të vogël, e që mund të jetë një obligim shumë i rëndë. ***Ky detyrim i kryetarëve të gjykatave duhet të formulohet në mënyrë që të ketë të bëjë vetëm me shkeljet evidente dhe të vrazhda të kryera nga ana e gjyqtarëve, të njohura për kryetarin dhe jo për çdo parregullsi potenciale.***²⁰⁹ Me ndryshimet e propozuara edhe pse reduktohen dhe precizohen në mënyrë shtesë formulimet në lidhje me bazat, megjithatë, akoma ekzistojnë formulime të përgjithshme për të cilat kryetari e ka për detyrë të hap procedurë para Këshillit Gjyqësor për ngritje të përgjegjësive. Në këtë drejtim rekomandohet të riformulohet neni 79, paragrafi 1, alineja 12 nga Ligji për gjykata në të cilin do të theksohet se kryetari mund të shkarkohet nëse nuk paraqet propozim për ngritje të procedurës për përcaktimin e përgjegjësive së gjyqtarit, për shkelje evidente dhe të vrazhda të kryera nga ana e gjyqtarëve, për të cilat kryetari ka qenë në dijeni.


Me ndryshimet e fundit të Ligjit për gjykata nga muaji maj i vitit 2018 është parashikuar që kryetari mund të shkarkohet nëse nuk e njofton Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë për shkeljen e kryer të rëndë disiplinore nga gjyqtari për të cilin ngihet procedurë për përgjegjësi disiplinore të gjyqtarit, në përputhje me nenin 76 paragrafin (2) të Ligjit për gjykata, i cili ka të bëjë me pamundësimin e ushtrimit të mbikëqyrjes mbi punën e gjyqtarit nga ana e gjykatës më të lartë. Me ndryshimet e propozuara kjo aline shlyhet.

Me ndryshimet e propozuara të Ligjit për gjykata shtohet paragrafi i ri në nenin 78, i cili ofron më shumë rrethana që duhet t'i ketë parasysh Këshilli Gjyqësor gjatë përcaktimit të masës disiplinore. Parashikohet që gjatë përcaktimit dhe shqiptimit të masës disiplinore detyrimisht të merret parasysh pesha e shkeljes, shkalla e përgjegjësive, rrethanat në të cilat është kryer shkelja dhe sjellja e gjyqtarit, pasojat nga shkelja e bërë, si dhe masat paraprakisht të shqiptuara disiplinore.²¹⁰

208 Neni 79, paragrafi 1, alineja 12 nga Ligji për gjykata

209 Komisioni i Venecias, opinionimi për Ligjin për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për Këshillin Gjyqësor dhe Ligjin për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për gjykata, 22 tetor 2018, faqe. 16, i aksesshëm në: [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2018\)022-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2018)022-e)

210 Neni 30, nga propozim Ligji për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për gjykata, i publikuar ENER më datë 09.11.2018.



5. SISTEMI INFORMATIK GJYQËSOR

5.1 Analiza e dokumenteve dhe standardeve ndërkombëtare

Shpërndarja e lëndëve deri te gjyqtarët është kryesore në lidhje me garantimin e paanshmërisë së gjyqtarëve.

Komisioni Evropian në Raportin e vitit 2016 konstatoi se sistemi informatikë për administrimin me lëndë gjyqësore ka nevojë të mbindërtohet, me qëllim të parandalimit të abuzimeve sa i përket nevojës që të sigurohet se lëndët nuk mund t'i shpërndahen gjyqtarit konkret për shkaqe politike ose personale.²¹¹

Për abuzimin e këtij sistemi është prononcuar në detaje, Grupi i Ekspertëve të Rajnhard Pribe në Raportin e vitit 2017.²¹² Sipas tyre, ka indikacione se ky sistem shpeshherë ka qenë objekt i ndikimit të jashtëm, me qëllim që të sigurohet shpërndarja e dosarëve të ndjeshëm gjyqtarëve të caktuar. Kjo është bërë në disa mënyra. Fillimisht gjyqtari i pabesueshëm mund të sistematizohet në tjetër pjesë të gjykatës (për shembull, të bartet nga lëndë penale në ato civile), mesa duket kështu është vepruar në Gjykatën Themelore Shkup 1 (Gjykata Penale). Së dyti, lëndët nuk u janë shpërndarë gjyqtarëve të cilët kanë qenë në pushim vjetor ose kanë munguar për shkaqe të tjera. Së katejmi, Grupi i Ekspertëve ka siguruar informacione se disa gjyqtarë janë dakordësuar që të jenë të pa aksesshëm në momentet kur është dashur të shpërndahen lëndët sensitive, me qëllim që ta evitojnë presionin ndaj tyre. Së treti, dallimet në trajtimin e lëndëve të shpërndara sipas ligjit të vjetër për procedurë penale para vitit 2013 dhe ligjit të ri nga viti 2013 mund të shfrytëzohen për manipulimin e sistemit. Së katërti, sistemi është lehtësisht i aksesshëm dhe i kurdisur nga ana e personave të caktuar, siç janë kryetarët e gjykatave. Grupi është njoftuar se kjo gjë ka ndodhur.

211 https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2016/20161109_report_the_former_yugoslav_republic_of_macedonia.pdf

212 https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/2017.09.14_seg_report_on_systemic_rol_issues_for_publication.pdf

5.2 Gjendjet në RM në lidhje me sistemin e automatizuar për administrim me lëndët gjyqësore (AKMIS)

Sistemi i automatizuar për administrimin me lëndët gjyqësore (AKMIS) u instalua në të gjitha gjykatat në vitin 2009, ndërsa shpërndarja e rastësishme e lëndëve është operative nga viti 2010 si pjesë e këtij sistemi.²¹³

Sa u përket pikëpamjeve të publikut profesionistë si dhe të Raportit të Grupit të Ekspertëve i udhëhequr nga Pribe u paraqitën indicie për abuzime të mundshme të sistemit AKMIS. Në drejtim të parandalimit të veprimtë njëanshëm dhe neglizhimin dhe abuzimin e sistemit për shpërndarje elektronike të lëndëve (AKMIS) nëpër gjykata për të cilën gjë duhet të zbatohen procedura për shqyrtimin e mënyrës së përdorimit të tij nëpër gjykatat në gjithë territorin e shtetit.²¹⁴ Në Strategji është parashikuar Funksionimi i drejtë i sistemit për shpërndarjen e lëndëve gjyqësore (AKMIS) përmes zbatimit të kontrolleve të rregullta dhe revizionit mbi funksionimin e tij, me qëllim që të parandalohen abuzimet e mundshme ndaj sistemit.²¹⁵

Të dhënat serioze për ndërhyrjen e drejtpërdrejt në shpërndarjen e lëndëve deri te gjyqtarët i hulumtoi Ministria e Drejtësisë në bazë të Ligjit për gjykata dhe në bazë të Rregullores gjyqësore. Në raportin e tyre konkludojnë se në kundërshtim me Ligjin, Gjykata Themelore Shkup 1 dhe Gjykata Supreme në vend që t'i ndajnë me kompjuter, lëndët gjyqësore i kanë shpërndarë në mënyrë manuale, ndërsa në njërin nga rekomandimet që ka të bëjë me Ligjin për gjykata theksohet se duhet të përforcohen kontrollet e gjykatave më të larta mbi gjykatat më të ulëta, me vërejtje dhe masa konkrete për monitorimin e parregullive të konstatuara dhe evitimin e tyre me qëllim të respektimit konsekuent të Ligjit për gjykata dhe ligjeve tjera relevante.²¹⁶

Nga hulumtimi i realizuar në terren rezultoi se nevojitet të zbatohet revizioni, si dhe të bëhet avancimi i sistemit AKMIS. Ekzistojnë numra të ndryshëm në Këshillin Gjyqësor, Gjykatën Supreme dhe Ministrinë e Drejtësisë lidhur me të dhënat e sistemit AKMIS. Nëse ka nevojë që të nxirren numra të saktë në lidhje me atë se sa hetime janë bërë në të kaluarën, vlerësim të aktakuzave, konteste me vlerë të vogël, masa të përkohshme, *të dhënat re sakta duhet* të nxirren në mënyrë manuale. Një pjesë e administruesve gjyqësorë në mënyrë manuale i nxjerrin këto numra dhe i paraqesin si raport deri te Gjykata Supreme e RM-së.²¹⁷ Sistemi AKMIS lejon vetëm të ceken gjyqtarët e tjerë të cilët kanë qenë pjesë të Kolegjit Penal përveç kryetarit të Kolegjit.²¹⁸

213 E sanksionuar me ligj në vitin 2006

214 Strategjia për reformë të sektorit të jurisprudencës 2017 – 2022, faqe 9

215 Ibid. faqe 10

216 <http://justice.gov.mk/Upload/Documents/%D0%90%D0%9A%D0%9C%D0%98%D0%A1%20%D0%B8%D0%B7%D0%B2%D0%B5%D1%88%D1%82%D0%B0%D1%98.pdf>

217 Qëndrimi i prezantuar nga administruesit gjyqësor në fokus grupin në Shkup, më datë 15.10.2018.

218 Qëndrimi i gjyqtarit në fokus grupin në Shkup, më datë 15.10.2018.

5.3 Opsione në lidhje me sistemin informatik gjyqësor dhe ndikimi i tyre

5.3.1 Opsioni – Gjendje e pandryshuar në lidhje me sistemin informatikë gjyqësor

Opsioni i këtillë do të çoj në jofunksionalitet të plotë të sistemit. Përsëri do të pranohen të dhëna dhe numra të ndryshme në Ministrinë e Drejtësisë, Gjykatën Supreme dhe Këshillin Gjyqësor. Nuk do të ketë mundësi për nxjerrjen e të dhënave të sakta dhe precize në lidhje me çështjet më të rëndësishme të Kapitullit 23 dhe Kapitullit 24 si kapituj kryesorë në procesin e eurointegritimit.

5.3.2 Opsioni - Avancimi i revizionit të sistemit informatikë gjyqësor

- Kontroll i vazhdueshëm mbi funksionimin e sistemit;
- Unifikimi i të dhënave në sistemin AKMIS;
- Të dhëna të mjaftueshme dhe çdo gjyqtar të ketë qasje të shoh se si bëhet shpërndarja e lëndëve;
- Inkorporimi i më shumë të dhënave të nevojshme, veçanërisht në lidhje me negociatat aderuese me Bashkimin Evropian;
- Azhurnimi i vazhdueshëm dhe mirëmbajtja e sistemit;
- Transparenca për shfrytëzues të jashtëm dhe lidhja me Entin Shtetëror të Statistikave.

Është i domosdoshëm kontroll i vazhdueshëm, mbikëqyrje mbi funksionalitetin e sistemit operativ AKMIS. Nevojitet mbikëqyrje që do të tregoj: nëse konform Ligjit për administrimin dhe lëvizjen e lëndëve, i cili është akti themelor që aplikohet për sistemin AKMIS, sistemi AKMIS funksionon ose nuk funksionon; cilat janë pengesat, cilat janë sfidat, përkatësisht cilat janë mundësitë që i ofron sistemi AKMIS për realizimin e plotë të funksioneve të tij. Sistemi AKMIS nuk e ka vetëm funksionin e shpërndarjes automatike të lëndëve. Ai, sipas definicionit, është regjistruar elektronik në të cilin shënohen të gjitha informacionet që kanë të bëjnë me një lëndë të caktuar. Nëse në mënyrë të drejtë dhe të plotë përdoret sistemi, atëherë çdo gjë që nevojitet si e dhënë mund të fitohet nga sistemi AKMIS.²¹⁹

Ekzistojnë numra të ndryshëm në Këshillin Gjyqësor, Gjykatën Supreme dhe në Ministrinë e Drejtësisë në lidhje me të dhënat e sistemit AKMIS. Nëse keni nevojë të nxirrni të dhëna dhe numra të saktë në lidhje me atë se sa hetime ka pasur në të kaluarën, notimin e aktakuzave, kontestet me vlerë të vogël, masat

²¹⁹ Intervistë me gjyqtar, më datë 12.11.2018.

e përkohshme, të dhënat e sakta duhet të nxirren në mënyrë manuale.²²⁰ Një pjesë e administruesve gjyqësorë në mënyrë manuale i nxjerrin këto numra dhe i dërgojnë si raport deri te Gjykata Supreme e RM. Duhet të vlerësohet puna edhe e gjyqtarëve në Kolegjin Penal, përveç kryetarit të Kolegjit. Sistemi AKMIS lejon vetëm të ceken gjyqtarët e tjerë të cilët kanë marrë pjesë në Kolegjin Penal, përveç kryetarit të Kolegjit. *Nevojitet unifikimi i të dhënave të sistemit AKMIS. Duhet të ketë të dhëna të mjaftueshme dhe çdo gjyqtarë të ketë qasje të shoh se si shpërndahen lëndët. Është e domosdoshme që në avancimin e sistemit të inkorporohen më shumë të dhëna të cilat janë të nevojshme, veçanërisht në lidhje me negociatat aderuese me Bashkimin Evropian.* Në këtë drejtim, duhet të inkorporohen edhe të dhënat lidhur me procedurat e iniciuara për ndërmjetësim, me qëllim që të merren në konsideratë edhe këto numra.

Duhet të ketë një pjesë të hapur të sistemit të automatizuar gjyqësor i cili do të jetë transparent për shfrytëzuesit e jashtëm. Nevojitet që pjesa statistikore të jetë transparente edhe për shfrytëzuesit e jashtëm, të dhënat statistikore duhet të jenë të lidhura edhe me Entin Shtetëror të Statistikave. Duhet të mundësohet që palët të jenë të lidhur me dosarin e lëndës. Çdo shfrytëzues i sistemit të ketë qasje në sistem në lidhje me të dhënat të cilat janë të autorizuar t'i pranojnë.²²¹

Duhet që sistemi i ri ose i avancuar kompjuterik të vihet në funksion të qytetarëve si shfrytëzues të fundit, përkatësisht të gjitha të dhënat për qytetarin të cilat mund t'i pranoj nga një gjykatë e caktuar kompetente, të njëjtat t'i pranojnë nga të gjitha gjykatat themelore në RM.²²²

Zgjidhja e këtillë do të ketë implikime financiare lidhur me avancimin e sistemit. Gjatë furnizimit të sistemit të ri duhet të merren parasysh edhe shpenzimet për mirëmbajtje. Nevojitet që sistemi i ri i kompjuterizuar të servisohet rregullisht.²²³

5.3.3 Opsioni – Ndryshimi i Ligjit për gjykata në lidhje me trupin për administrim me sistemin informatikë gjyqësor dhe themelimin e Qendrës për koordinimin dhe avancimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në organet e jurisprudencës

- Themelimi i Qendrës për koordinimin dhe avancimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në organet e jurisprudencës;
- Revidimi i përbërjes së trupit punues për standardizimin e procedurave në gjykata.

220 Qëndrimi i administruesit gjyqësor i prezantuar në fokus grupin në Shkup

221 Intervistë me përfaqësuesin e Ministrisë së Drejtësisë, më datë 16.10.2018.

222 Si shembuj u potencuan vërtetimet për mosdënim, mos mbajtje të procedurës për vepër penale, aftësi pune etj., të cilat tani mund të fitohen tek gjykata sipas vendit të lindjes ose vendit të vendbanimit.

223 Intervistë me ekspert juridik, më datë 09.11.2018.

Me Ligjin për gjykata parashikohet që në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë të themelohet Qendra për Teknologjinë e Informacionit kompetente për administrimin teknik me sistemin e automatizuar kompjuterik për administrimin me lëndë gjyqësore dhe bazat e të dhënave të cilat rezultojnë nga puna e gjykatave.²²⁴ Në Rregulloren gjyqësore është parashikuar që për përdorimin dhe avancimin e sistemit të automatizuar kompjuterik për administrimin me lëndë gjyqësore në gjykata, kryetari i Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë duhet të formoj trup punues për standardizimin e procedurave në gjykata.²²⁵ Trupi punues përbëhet nga: anëtari i Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë, një gjyqtar nga Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë, një gjyqtarë nga Gjykata e Lartë Administrative, një gjyqtar nga Gjykata Administrative, nga një gjyqtar nga çdo juridiksion i apelit, dy gjyqtarë nga gjykatat themelore (me kompetencë të zgjeruar dhe themelore), nga përfaqësuesi i autorizuar i Qendrës për Informatikë në gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë dhe koordinatori – sekretari teknik i punësuar në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë.²²⁶ Me ndryshimet e propozuara të Ligjit për gjykata, ky organ rregullohet me Ligjin për gjykata. Në propozim-ndryshimet theksohet se në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë formohet trupi punues për standardizimin e procedurave në gjykata i përbërë nga një gjyqtar i Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë, nga një gjyqtar nga secila Gjykatë e Apelit, një gjyqtarë nga Gjykata Administrative, një gjyqtar nga Gjykata e Lartë Administrative, një gjyqtar nga Gjykata Themelore dhe administruesi i Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë.²²⁷ ***Me qëllim të standardizimit më të mirë të procedurave në gjykata duhet që ky trup të jetë më i vogël në të cilin duhet të jenë anëtarë më shumë gjyqtarë nga gjykata themelore, administrues gjyqësorë, madje edhe punonjës përgjegjës në arkivat dhe specialistë të teknologjisë së informacionit.***²²⁸

Ministria e Drejtësisë është shfrytëzuese e të dhënave statistikore të bazave të të dhënave nga sistemet informatike të gjykatave.²²⁹ Ndryshimet e propozuara të Ligjit për gjykata të publikuara në ENER e parashikojnë formimin e Qendrës për koordinimin dhe avancimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në organet e jurisprudencës.²³⁰ Qendra është kompetente për krijimin dhe realizimin e strategjive dhe politikave të teknologjive të informacionit dhe komunikimit në sistemin e jurisprudencës.²³¹ Kjo u vlerësua si e domosdoshme për shkak të unifikimit të të dhënave të cilat pranohen nga të gjitha organet e jurisprudencës, duke e pasur parasysh faktin se Ministria e Drejtësisë është institucioni kompetent për hartimin dhe implementimin e Strategjisë së teknologjisë së informacionit. Nga ana tjetër, përcaktohet se Ministria e Drejtësisë paraqitet vetëm si shfrytëzuese e të dhënave statistikore të këtij sistemi me çka do të tejkalohet problemi aktual me të dhënat e pa unifikuara statistikore të institucioneve të jurisprudencës. Ky ndryshim është i domosdoshëm për periudhën e ardhshme sa i përket vlerësimit

224 Neni 99, paragrafi 1 nga Ligji për gjykata

225 Neni 8 i Rregullores gjyqësore, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 66 më datë 09.05.2013.

226 Neni 9 i Rregullores gjyqësore, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 66 më datë 09.05.2013.

227 Neni 34 i Propozim ligjit për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për gjykata i publikuar në ENER më datë 09.11.2018.

228 Qëndrimi i administruesit gjyqësor i prezantuar në fokus grupin në Shkup, më datë 15.10.2018.

229 Neni 86, paragrafi 4 i Ligjit për gjykata.

230 Neni 32 i Propozim ligjit për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për gjykata të publikuara në ENER më datë 09.11.2018.


231 Ibid.

të fushës së jurisprudencës në procesin e integrimi euroatlantike.²³² Përveç kësaj, kjo korrespondon me nenin 99 paragrafin 6 të Ligjit për gjykata, sipas të cilit Ministria e Drejtësisë me akt nënligjor e përcakton mënyrën e vendosjes, mirëmbajtjes dhe funksionimit të sistemit të informacionit mbi bazën unike, metodologjike dhe teknologjike.²³³

Ky opsion do të ketë implikime financiare sa i përket formimit të Qendrës për koordinimin dhe avancimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në organet e jurisprudencës. Nga ana tjetër, kjo zgjidhje do nxisë punësime të reja. Ky opsion do të jetë efektiv vetëm nëse do të avancohet sistemi gjyqësor i informacionit.

232 Propozim ligji për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për gjykata i publikuar në ENER më datë 09.11.2018.

233 Neni 99 i Ligjit për gjykata



6. MJETET E PUNËS

Çështja që ka të bëjë me buxhetet e gjykatave vazhdimisht përsëritet ndër vite. Edhe pse çdo vit buxhetet e gjykatave shënojnë rritje, megjithatë mjetet që akordohen nuk mjaftojnë që të përmbushen nevojat e institucioneve gjyqësore. Buxheti në total për vitet e kaluara është në lartësi prej 0.4% e që është më i ulët nga buxheti i parashikuar ligjor për gjykatat e që është në lartësi prej 0,8%. Komisioni Evropian në raportin e fundit ka konstatuar se buxhetet e gjykatave për vitin 2017 ishin në lartësi prej 14,9 euro për kokë banori.²³⁴ Ky nivel i financimit është një shkallë mjaft më e ulët në krahasim me mesataren evropiane për kokë banori. Republika e Maqedonisë ka 27 gjyqtarë dhe 8 prokurorë për 100 000 banorë, krahasuar me mesataren evropiane prej 21 gjyqtarë dhe 11 prokurorë për 100 000 banorë në vitin 2014. Gjithashtu, 80% e buxhetit të përgjithshëm shpenzohet për paga e që e vë në dukje nevojën e një sistemi të veçantë për administrimin e resurseve njerëzore ose Strategji e fokusuar mbi përmirësimin e alokimit të resurseve.

Në vitin 2017 buxheti i miratuar në total për pushtetin gjyqësor për dy programet ishte në lartësi prej 1.894.994.000 denarë. Prej këtyre mjeteve 1.834.314.000 denarë u akorduan si shpenzime të Buxhetit themelor të Republikës së Maqedonisë në llogarinë buxhetore, 57.680.000 denarë si shpenzime nga Buxheti themelor i Republikës së Maqedonisë në llogarinë e të ardhurave vetjake dhe 3.000.000 denarë u akorduan për shpenzime nga donacione. Mjetet e llogarisë nga të ardhurat vetjake janë realizuar nga arkëtimi i pagesave kuturu gjyqësore dhe nga qiraja e hapësirave të dhëna afariste që në përputhje me Ligjin për buxhetin gjyqësor janë të ardhura të gjykatave. Në përputhje me nenin 4 të Ligjit për buxhetin gjyqësor parashikohet se pjesa e mjeteve “Pushteti gjyqësor” në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë, të nevojshme për funksionimin e njësive shfrytëzuese përcaktohet në shumë prej më së paku 0,8% nga bruto prodhimi vjetor, megjithatë kjo përqindje për vitin 2017 ishte në lartësi prej 0,34% nga bruto prodhimi vendor. Gjatë vitit u bë rishikimi i Buxhetit të Republikës së Maqedonisë (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.109 nga data 13.08.2017), me ç’rastu reduktuan mjetet e dedikuara për financimin e pushtetit gjyqësor në kundërshtim me nenin 4 paragrafin 2 të Ligjit për buxhetin gjyqësor. Gjatë vitit u bënë edhe

²³⁴ <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20180417-the-former-yugoslav-republic-of-macedonia-report.pdf>

ndryshime të caktuara, me qëllim të shfrytëzimit maksimal të mjeteve në përputhje me nevojat e njësive shfrytëzuese të pushtetit gjyqësor. Së këtejmi, përqindja më e madhe e buxhetit gjyqësor shpenzohet për kategorinë kompensim dhe paga.²³⁵

Në Strategjinë për reformë të sektorit të jurisprudencës, si njëra nga dobësitë e buxhetit gjyqësor është moszbatimi i dispozitave ligjore për lartësinë e buxhetit gjyqësor prej **0,8% nga BPV**.²³⁶ Njëra nga masat e parashikuara në Strategji është përmirësimi i gjendjes me zbatimin e Ligjit për buxhetin gjyqësor, **ndërsa në Planin e Veprimit është parashikuar që buxheti gjyqësor nga viti 2019 të jetë në lartësi prej 0,6 për qind nga BPV, ndërsa për vitin 2021 në lartësi prej 0,8% nga BPV**.²³⁷

Sa i përket numrit të gjyqtarëve për 100000 banorë, Komisioni Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë në “Sistemi evropian: efikasiteti dhe kualiteti i drejtësisë” edicioni 2018 thekson se Republika e Maqedonisë është mbi mesataren evropiane. Nëse bëjmë një krahasim rajonal, numër më të madh të gjyqtarëve kanë të gjitha shtetet e rajonit përveç Shqipërisë.²³⁸ Numri i gjyqtarëve është reduktuar nga viti 2014 deri në vitin 2017.

235 Raport për punën e Këshillit Gjyqësor për vitin 2017, i aksesshëm në:<https://goo.gl/6de4BP>

236 Strategjia për reformë të sektorit të jurisprudencës për periudhën kohore 2017 – 2022, e aksesshme në:<https://goo.gl/BTxazo>

237 Plan Veprimi i Strategjisë për reformë të sektorit të jurisprudencës për periudhën kohore 2017 – 2022. I aksesshëm në:

<http://www.pravda.gov.mk/Upload/Documents/29.11.2017AkciskiPlannovo%20za%20vob.pdf>

238 Numër më të madh të gjyqtarëve kanë Serbia, Mali i Zi, Bosnja e Hercegovina, Bullgaria, Sllovenia dhe Kroacia.



PIKËPAMJET DHE REKOMANDIMET PËRFUNDIMTARE

Në Ministrinë e Drejtësisë ekziston procesi inkluziv i konsultimeve lidhur me Ligjin për gjykata, përmes formimit të grupit të punës, publikimit të projekt – ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për gjykata në ENER e deri në organizimin e debateve publike në lidhje me propozim ndryshimet ligjore.

Ligji për gjykata dhe çështjet që kanë të bëjnë me zbatimin e ligjit janë të një rëndësie të jashtëzakonshme për negociatat aderuese me Bashkimin Evropian lidhur me Kapitullin 23: Jurisprudenca dhe liritë themelore të njeriut. Nga ana tjetër, në këto fusha Bashkimi Evropian nuk ka legjislacion të vet, meqë shtetet që aderojnë duhet t'i vlerësojnë me kujdes ndikimet mbi legjislacionet e tyre (zgjidhje të propozuara).

Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për gjykata në muajin maj të vitit 2018 nuk i adresuan qëndrimet e gjyqësorit, si dhe rekomandimet e përfshira në opinionet e Komisionit të Venecias.

Ndryshimet e propozuara të Ligjit të publikuara në ENER më datë 9 nëntor të vitit 2018 janë në drejtim të përmbushjes së rekomandimeve nga raportet ndërkombëtare dhe opinionet e gjyqtarëve. Nevojitet monitorim konsekuent mbi implementimin e zgjidhjeve ligjore pas miratimit të të njëjtave.

Gjithsesi se, ndikimet e pritshme nga opsionet, objekt të këtij hulumtimi, duhet të monitorohen për një kohë gjatë bashkë me ndikimet e zgjidhjeve të tjera ligjore të gjyqësorit. Ky rekomandim rezulton nga të anketuarit, por është edhe nevojë si rezultat i proceseve lidhur me fillimin e negociatave aderuese në Bashkimin Evropian.

Ministria e Drejtësisë dhe Kuvendi i RM

1. Para se t'i qaset ndryshimeve në rrjetin gjyqësor u paralajmërua analizë nga ana e Ministrisë së Drejtësisë e cila nuk u publikua.
2. Analiza jonë tregon se është i domosdoshëm racionalizimi dhe optimizimi i rrjetit gjyqësor në këto drejtime:
 - Një pjesë e gjykatave më të vogla të cilat nuk kanë numër të mjaftueshëm të lëndëve në punë dhe kanë numër të vogël të gjyqtarëve të mbeten seksione të gjykatave më të mëdha dhe të gjykatave me strukturë më të mirë të lokacionit; nevojitet që edhe në këto seksione të ketë arkiv dhe seksione pranimit, në mënyrë që qytetarët të mund ta realizojnë të drejtën e tyre edhe aty. Me një kalendar të mirë të kryetarit të gjykatës mund të dërgohen gjyqtarë të gjykojnë në këto seksione. Në këtë mënyrë do të arrihet ekonomizim edhe qytetarët edhe për buxhetin gjyqësor.
 - Tri gjykatat me kompetencë themelore, përkatësisht Gjykata Themelore në Kërçovë, Gjykata Themelore në Gjevgjeli dhe Gjykata Themelore në Kavadar, të cilat dallojnë për nga prurja e lëndëve dhe numri i përgjithshëm i lëndëve në punë, për dallim nga gjykatat e tjera me kompetencë themelore, është e nevojshme të jenë gjykata me kompetencë të njëjtë reale, si edhe gjykatat me kompetencë të zgjeruar.²³⁹Këto gjykata kanë numër më të madh të gjyqtarëve në krahasim me disa gjykata me kompetencë të zgjeruar.
 - Një pjesë e gjykatave themelore të cilat kanë pozitë të mirë gjeografike dhe numër jo edhe aq të vogël të lëndëve do të duhet të kenë kompetencë të rritur reale, megjithatë jo kompetencë të njëjtë reale si të gjykatave të tjera të cilat kanë kompetencë të zgjeruar. Ky rekomandim duhet të shqyrtohet përkundrejt mundësisë që të bashkohen dy gjykata më të vogla, me ç'rast në njërin nga komunat do të ekzistonin seksione, kështu që gjykata do të kishte lëndë në punë dhe numër të mjaftueshëm të gjyqtarëve që të ketë kompetencë si gjykatë me kompetencë të zgjeruar.
 - Veprat e krimit të organizuar të gjykohen në më shumë qendra, jo vetëm në Seksionin për krim dhe korrupsion të organizuar në Gjykatën Themelore Shkup 1;
 - Revidim të kompetencës reale të seksioneve për krim të organizuar, me ç'rast veprat të cilat tani janë në kompetencë të seksionit për krim të organizuar të jenë në kompetencë edhe të gjykatave të tjera themelore;
 - Ndryshimet e strukturës organizative të gjyqësisë administrative, për çka nevojitet një analizë shtesë dhe debat, duke i pasur parasysh qëndrimet e ndryshme.

²³⁹ Kompetencë e zgjeruar këtyre gjykatave u është dhënë me propozim ndryshimet të cilat janë Miratuar nga Qeveri në mbledhjen e 108 më datë 12.12.2018, të cilat në dhjetor të vitit 2018 janë në procedurë kuvendore.

3. Rekomandimet e raporteve ndërkombëtare lidhur me zgjedhjen dhe avancimin e gjyqtarëve janë marrë parasysh në ndryshimet e propozuara e të publikuara në ENER si dhe ndryshimet e miratuara nga ana e Qeverisë të cilat janë në procedurë parlamentare. Megjithatë, sa u përket kritereve për avancimin e gjyqtarëve edhe ekspertët janë të mendimit se nevojitet të rritet stazhi i gjyqtarit për avancimin e gjyqtarëve.
4. Me ndryshimet e propozuara të Ligjit për gjykata,²⁴⁰ si dhe ndryshimet plotësuese sipas rekomandimit të Komisionit të Venecias, implementohen rekomandimet e Komisionit të Venecias dhe rekomandimet e GREKO lidhur me bazat për përgjegjësinë e gjyqtarëve. Nevojitet implementim konsekuent dhe respektimi i këtyre rekomandimeve.

Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë

5. Vendimet në lidhje me (mos)zgjedhjen e gjyqtarëve duhet të elaborohen në detaje dhe të arsyetohen me qëllim që të mos lihet hapësirë për mosbesim si sa u përket vendimeve ashtu edhe sa i përket sistemit të përgjithshëm të jurisprudencës. Është e nevojshme të ndërtohet praktikë e Këshillit Gjyqësor, sa i përket aplikimit të këtyre kritereve me qëllim të fuqizimit të besimit ndaj këtij institucioni.

Ministria e Drejtësisë, Këshilli Buxhetor Gjyqësor, Ministria e Financave

6. Ky hulumtim e vë në dukje se është i nevojshëm avancimi dhe revizioni i sistemit informatikë gjyqësor, me qëllim të funksionalizimit të tij të plotë. Në këtë drejtim nevojitet:
 - Kontroll i vazhdueshëm mbi funksionimin e sistemit;
 - Unifikimi i të dhënave në sistemin AKMIS.
 - Të dhëna të mjaftueshme dhe çdo gjyqtar të ketë qasje të shoh si bëhet shpërndarja e lëndëve;
 - Inkorporimi i më shumë të dhënave të cilat janë të nevojshme, veçanërisht në lidhje me negociatat aderuese me Bashkimin Evropian; Në këtë drejtim, duhet të inkorporohen edhe të dhëna lidhur me procedurat e iniciuara për ndërmjetësim.
 - Duhet të ketë një pjesë të hapur nga sistemi i automatizuar gjyqësor i cili do të jetë transparent për shfrytëzuesit e jashtëm. Nevojitet që pjesa statistikore të jetë e hapur edhe për shfrytëzuesit e jashtëm, të dhënat statistikore duhet të lidhen edhe me Entin Shtetëror të Statistikave. Duhet të mundësohet që palët të kenë lidhje me dosarin e lëndës. Çdo shfrytëzues i sistemit të ketë qasje deri te sistemi, lidhur me të dhënat për të cilat janë të autorizuar t'i pranojnë.

240 Të publikuara në ENER më datë 09.11.2018.

- Nevojitet që sistemi i ri ose sistemi i avancuar kompjuterik të vihet në funksion të qytetarëve si shfrytëzues të fundit, përkatësisht të gjitha të dhënat të cilat qytetari mund t'i pranoj nga ndonjë gjykatë e caktuar kompetente të njëjtat t'i pranoj nga të gjitha gjykatat themelore në RM.
- Azhurnim dhe mirëmbajtje e vazhdueshme e sistemit;

